

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6784
E shtunë, 17 dhjetor 2022
çmimi 0.40

Qeveria miraton draftin e strategjisë së energjisë 2022-2031 | FAQE 8



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GJYKATA SPECIALE SHPALL AKTGJYKIMIN PËR ISH-KOMANDANTIN E USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS, SALIH MUSTAFA | FAQE 3

GJYKATA SPECIALE E DËNON ME 26 VJET BURGIM KOMANDANT 'CALIN'



Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Salih Mustafa, është dënuar të premtën nga Gjykata Speciale, me seli në Hagë, me 26 vjet burgim për vrasje të paligjshme, ndalim arbitrar dhe torturë. Ndaj këtij vendimi të Speciales ka pasur reagime të shumta në Kosovë, duke e vlerësuar si

dënim të padrejtë dhe të pabazë. Përfaqësues të OVLUÇK-së kanë theksuar se Gjykata Speciale bazohet në dëshmitarë të fshehur nga populli e dënon në emër të popullit. Sipas tyre, lufta e UÇK-së ishte e drejtë, e pashmangshme dhe e domosdoshme

FLET PËR "EPOKËN E RE", HISEN BERISHA | FAQE 4-5

SERBIA NË VERI PO IMITON RUSINË PARA SE AJO TA SULMONTE UKRAINËN

- Plani franko-gjerman i shërben Serbisë për ruajtjen e status-quos

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Hisen Berisha, ka thënë se Serbia është duke e imituar Rusinë në veri të Kosovës para se ajo ta sulmonte Ukrainën. Sipas Berishës, situata në veri është me rrezikshmëri të lartë. Në këtë intervistë dhënë "Epokës së re", Berisha ka thënë se ShBA-ja dhe BE-ja duhet t'i detyrojnë serbët jo vetëm t'i largojnë barrikadat, por edhe t'i dorëzojnë kriminelët që kanë organizuar plagosjen e policit dhe nxitur tensionimin e situatës në veri



AKTUALE



VON CRAMON THOTË SE INTEGRIMI I KOSOVËS NË BE VARET EDHE NGA DIALOGU ME SERBINË | F. 5

KURTI NË PRITJE TË KFOR-it PËR HEQJEN E BARRIKADAVE | F. 4

ARRESTOHET NJË SERB I DYSHUAR PËR KRIME LUFTË | F. 7

EKONOMI



ESCOBARI THOTË SE SHBA-ja PËRKRAH INTEGRIMIN EKONOMIK TË TREGJEVE RAJONALE | F. 8

KUVENDI MIRATON BUXHETIN PËR VITIN 2023 | F. 8

SPORT



KROACIA DHE MAROKU 'LUFTOJNË' PËR VENDIN E TRETË | F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rusia nis sulme të reja vdekjeprurëse në Ukrainë

KIEV, 16 DHJETOR - Të premten është raportuar për sulme të reja ruse me raketa në gjithë Ukrainën, derisa Kievi ka thënë se Moska mund ta nisë një ofensivë të re në fillim të vitit të ardhshëm. Autoritetet ukrainase kanë raportuar për shpërthime në të paktën tri qytete më 16 dhjetor, duke thënë se Rusia ka nisur sulme të mëdha me raketa në objektet energjetike dhe infrastrukturën kyçe. Autoritetet lokale kanë raportuar në rrjetet sociale se shpërthime ka pasur në Kiev, në pjesën jugore të Kryviy Rih në rajonin

Dnjipropetrovsk dhe në pjesën verilindore të Harkivit. Kryetari i Harkivit, Ihor Terekhov, ka thënë në "Telegram" se qyteti ka mbetur pa energji elektrike pasi, sipas autoriteteve, tri raketa kanë goditur pika kyçe të infrastrukturës. Për ndërprerje të energjisë është raportuar edhe në rajonin Sumoj në lindje. Në Kiev autoritetet kanë thënë se "mbrojtja ajrore në rajon është në funksion". Sulmet që kanë cak infrastrukturën energjetike janë bërë pjesë e strategjisë së re ruse për t'i detyruar ukrainasit të

nënshtrohen gjatë dimrit me ngrica, pas disa humbjeve të mëdha të forcave ruse në fushëbetëje në muajt e fundit. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt. Presidenti rus, Vladimir Putin e quan luftën si "operacion special ushtarak" për të çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Ruisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.



Dhjetë persona të vdekur si pasojë e zjarrit në Francë



LION, 16 DHJETOR - Dhjetë persona, përfshirë pesë fëmijë, kanë vdekur si pasojë e zjarrit në një ndërtesë afër qytetit Lion të Francës, kanë thënë autoritetet lokale. Sipas tyre zjarri ka shpërthyer në një ndërtesë shtatëkatëshe në Vaulx-en-Velin. Katër persona janë në gjendje kritike dhe 10 persona është

raportuar se kanë plagë lehta. Zjarri është shuar nga 170 zjarrfikës, të cilët kanë qenë në skenën e incidentit prej orës 03:00 të mëngjesit të ditës së premte. Olivier Klein, ministër i deleguar për rajonin Borne, ka thënë se raporti fillestar është "rrëqethës". Ministri i Brendshëm francez, Gerard Darmanin, ka thënë se

shkaku i zjarrit nuk dihet ende dhe i ka falënderuar zjarrfikësit që kanë shpëtuar njerëzit "në kushte jashtëzakonisht të vështira". Ai ka thënë se fëmijët që kanë vdekur kanë qenë të moshave nga tre deri në 15 vjeç. Darmanin ka thënë se hetimet lidhur me shkaqet e zjarrit do të bëhen publike më vonë gjatë së premtes.

Liderët e BE-së konfirmojnë statusin e vendit kandidat për Bosnjë-Hercegovinën


BRUKSEL, 16 DHJETOR - Liderët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, në samitin që u mbajt në Bruksel, konfirmuan statusin e vendit kandidat për Bosnje e Hercegovinën "Këshilli Evropian mbështet konkluzionet Këshilli për Çështje të Përgjithshme i BE-së, të datës 13 dhjetor 2022, për procesin e zgjerimit dhe stabilizim-asociimit, dhe pranon t'i japë Bosnje e Hercegovinës statusin e vendit kandidat", thuhet në konkluzionet e miratuara nga liderët e BE-së, në të cilat Evropa e Lirë pati qasje. Vendimi për dhënien e statusit

kandidat për Bosnjën tashmë është marrë nga ministrat përgjegjës për çështje evropiane në takimin e mbajtur më 13 dhjetor dhe konfirmimi i sotëm është vetëm zyrtarizimi i statusit të vendit kandidat. Në tetor, Komisioni Evropian rekomandojë dhënien e statusit kandidat dhe anëtarësimin e plotë të Bosnjës në BE, por tha se shteti duhet të përmbushë disa kriterë. Në mesin e kriterëve të vendosura për Sarajevën ishin miratimi i ndryshimeve në ligjet për gjykatat dhe prokuroritë, miratimi i një ligji për parandalimin e konfliktit të

interesit, ndërmarrja e hapave konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, por edhe sigurimi i funksionimit të disa mekanizmave për përshtatjen e programeve kombëtare me ato të BE-së. Me Bosnje e Hercegovinën bëhen nëntë shtetet që kanë zyrtarisht statusin e vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Shtetet tjera janë Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia, Turqia, Ukraina dhe Moldavia.



Aeroporti i Shkupit rikthen fluturimet pas "alarmeve të rreme" për bomba



SHKUP, 16 DHJETOR - Ministria e Brendshme e Maqedonisë së Veriut ka bërë me dije se kërcënimet që i janë bërë Aeroportit të Shkupit të premten, kanë rezultuar të rreme, prandaj edhe është rikthyer orari i fluturimeve. Në orët e mëngjesit nuk ka pasur fluturime nga Shkupi, derisa ato që e kanë pasur destinacion kryeqytetin maqedonas e kanë

devijuar udhëtimin. Përveç aeroportit, kërcënime për bomba ka pasur edhe në disa objekte tjera: hotele, qendra tregtare, në 15 shkolla fillore dhe të mesme, në kopshte fëmijësh dhe qendra të ndryshme sportive. Si pasojë e këtyre kërcënimeve është evakuuar edhe hoteli "Aleksandar Palace", ku ka qenë kryeministri maqedonas,

Dimitar Kovaçevski dhe zyrtarë tjerë të Qeverisë. "Menjëherë pas marrjes së denoncimeve, nga punonjësit e policisë janë marrë masa për evakuimin e sigurt të objekteve dhe po kryhen kontrollet antiterroriste si dhe masat për zbardhjen e rasteve", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Brendshme të Maqedonisë së Veriut. Alarme për vendosje të

bombave ka pasur edhe ditën e mërkurë në 49 objekte të arsimit dhe institucioneve tjera shtetërore, por edhe në qytete tjera si në Kumanovë, Kavadar, Shtip dhe Manastir. Kryeministri, Dimitar Kovaçevski, ka thënë se institucionet po punojnë për zbardhjen e këtyre kërcënimeve që kanë nisur më 26 tetor.

GJYKATA SPECIALE SHPALL AKTGJYKIMIN PËR ISH-KOMANDANTIN E USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS, SALIH MUSTAFA

Gjykata Speciale e dënon me 26 vjet burgim komandant "Calin"

Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Salih Mustafa, është dënuar të premten nga Gjykata Speciale, me seli në Hagë, me 26 vjet burgim për vrasje të paligjshme, ndalim arbitrar dhe torturë. Ndaj këtij vendimi të Speciales ka pasur reagime të shumta në Kosovë, duke e vlerësuar dënim të padrejtë dhe të pabazë. Përfaqësues të OVLUÇK-së kanë theksuar se Gjykata Speciale bazohet në dëshmitarë të fshehur nga populli e dënon në emër të popullit. Sipas tyre, lufta e UÇK-së ishte e drejtë, e pashmangshme dhe e domosdoshme

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Salih Mustafa, i njohur si 'komandant Cali', është dënuar të premten nga Gjykata Speciale me seli në Hagë, me 26 vjet burgim për vrasje të paligjshme, ndalim arbitrar dhe torturë. "Sot, më 16 dhjetor 2022, trupi gjykues shqiptoi aktgjykimin në çështjen gjyqësore - Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës. Aktgjykimi shënon një moment të rëndësishëm për Dhomat e Specializuara të Kosovës ("DHSK"), duke qenë se është aktgjykimi i parë i kësaj gjykate në një çështje për krime të luftës. Trupi Gjykues e shpalli z. Mustafa fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme dhe e dënoi me 26 vjet burgim. Për arsye ligjore, Trupi Gjykues e shpalli z. Mustafa të pafajshëm për krimin e trajtimit mizor. Kur shqiptoi vendimin, Trupi Gjykues nënvizoi se akuzat në këtë çështje gjyqësore kanë të bëjnë vetëm me përgjegjësinë penale individuale të z. Mustafa dhe përfshirjen e tij në krimet e pretenduara të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme të viktimave", është thënë në njoftimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Duke vënë në dukje se viktimat në këtë çështje janë shqiptarë (kosovarë), Trupi Gjykues gjithashtu theksoi se "përpjekjet e tyre për ta gjetur drejtësinë dhe të vërtetën janë thelbi i këtij procesi". "Krimet për të cilat z. Mustafa u shpall fajtor ndodhën në prill 1999 në një kompleks në fshatin Zllash, në Kosovë, i cili përdorej si bazë nga njësitë gueril BIA i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), komandant i të cilit ishte z. Mustafa. Në aktgjykim, Trupi Gjykues konstatoi se gjatë konfliktit midis UÇK-së dhe forcave serbe, z. Mustafa ishte komandanti i vetëm dhe i përgjithshëm i njësitit gueril BIA të UÇK-së deri në shpërndarjen e tij; se ai kishte nën komandë kompleksin në Zllash gjatë periudhës kur ndodhën krimet e pretenduara; dhe se kishte kompetencë për emërimet në njësitin gueril BIA, për t'u dhënë

urdhra vartësve të vet dhe për t'i disiplinuar. Në lidhje me krimin e ndalimit arbitrar, Trupi Gjykues konstatoi se të paktën gjashtë persona u arrestuan nga anëtarë të BIA-s ose anëtarë të tjerë të UÇK-së dhe atyre iu hoq liria në kompleksin në Zllash pa iu treguar arsye e pa iu dhënë mundësi ta kundërshtonin ligjshmërinë e mbajtjes në ndalim. Provat vërtetuan se z. Mustafa ishte i pranishëm disa herë në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe i urdhëroi vartësit t'i kthenin të ndaluarit në vendin ku mbaheshin në ndalim", është thënë në njoftimin e DHSK-së.

Më tutje theksohet se "rrjedhimisht Trupi Gjykues konstatoi se Mustafa e dinte për mbajtjen e tyre në ndalim dhe kushtet e ndalimit". "Në lidhje me krimin e torturës, gjykatësit theksuan se të ndaluarit u akuzuan se ishin spiunë, bashkëpunëtorë të serbëve, tradhtarë, hajdutë, ose gënjeshtarë dhe u mbajtën në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese, pa ujë, ushqim dhe ndihmë mjekësore të mjaftueshme; nuk u lejohej larja e pastrimit ose ndërrimi i teshave, as përdorimi i objekteve sanitare. Z. Mustafa dhe vartësit e tij të BIA-s qëllimisht u shkakton dhimbje e vuajtje të mëdha të ndaluarve, me synimin e marrjes së informatave ose deklaratave pranuese, duke i ndëshkuar, frikësuar, shtrënguar dhe/ose diskriminuar për arsye politike. Trupi Gjykues theksoi se 'keqtrajtimi fizik dhe psikologjik, bashkë me kushtet çnjerëzore dhe poshtëruese të ndalimit, u shkakton të ndaluarve lëndime të përhershme fizike dhe psikologjike'. Në lidhje me krimin e vrasjes së paligjshme, Trupi Gjykues konstatoi se viktimat e vrasjes së paligjshme ishte pothuajse i vdekur kur si pasojë e ofensivës serbe në prill 1999, njësitë gueril BIA i liroi të burgosurit, me përjashtim të dy më të rrahurve egërsisht. Trupi Gjykues konstatoi si shkak të vdekjes keqtrajtimin e rëndë të shkakuar nga anëtarët e njësitit gueril BIA gjatë një periudhe prej pothuajse tri javësh dhe mungesën e ndihmës mjekësore për viktimën, si dhe disa plagë të shkaktuara nga armë zjarri, të



pranishme në kufomën e viktimës", është theksuar tutje në njoftimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Më tej thuhet se në lidhje me përgjegjësinë penale të Mustafës, Trupi Gjykues konstatoi se vetë Mustafa mori në pyetje dhe keqtrajtoi dy nga të ndaluarit, në raste të ndryshme, si dhe njërin prej tyre bëri sikur do ta ekzekutonte. "Në lidhje me pretendimet e tjera faktike mbi të cilat bazohen akuzat për krime, Trupi Gjykues konstatoi se z. Mustafa është penalisht përgjegjës përmes kontributit personal si pjesëmarrës i ndërmarrjes kriminale të përbashkët. Në përcaktimin e dënimit të z. Mustafa, Trupi Gjykues mori parasysh peshën e krimeve dhe kontributin personal të z. Mustafa në krimet. Egërsia e veçantë e torturave, pozita eprore e z. Mustafa si dhe përfshirja e drejtpërdrejtë personale e tij në këtë krim u vlerësuan nga Trupi Gjykues si faktorë rëndues. Kur shqiptoi vendimin e gjykimit Trupi Gjykues, theksoi guximin e jashtëzakonshëm të dëshmitarëve dhe viktimave që dhanë dëshmi me gjithë etiketimin e tyre në Kosovë si 'tradhtarë' apo 'bashkëpunëtorë' dhe kërcënimet e frikësimit për bashkëpunimin e tyre me Dhomat e Specializuara ose Prokurorin e Specializuar. Trupi Gjykues shpjegoi se atmosfera e frikës dhe frikësimit është arsyeja pse gjykatësit urdhëruan masa mbrojtëse për shumë dëshmitarë dhe viktimat në këtë çështje gjyqësore dhe theksoi se ajo ishte gjithashtu një nga arsyet për krijimin e kësaj gjykate dhe vendosjen e saj në Hagë", thuhet në njoftim.

Sipas njoftimit të DHSK-së, gjatë gjykimit Trupi Gjykues dëgjoi 28 dëshmitarë - 13 të thirrur nga Prokurori i Specializuar dhe 15 të

thirrur nga Mbrojtja. "Trupi Gjykues gjithashtu shqyrtoi deklaratat me shkrim, prova shkresore dhe aktekspertiza. Tetë viktimat morën pjesë në proces dhe të gjithë ishin nën masa mbrojtëse. Së fundi, Trupi Gjykues njoftoi se më pas do të lëshojë një urdhër për zhdëmtim dhe se ruan juridiksionin e nevojshëm në lidhje me këtë", është thënë në fund të njoftimit të DHSK-së. Mustafa është arrestuar dhe më pas është transferuar në njësinë e paraburgimit të Gjykatës Speciale më 24 shtator të vitit 2020.

Reagime të shumta për dënimin e komandant "Calit"

Ushtruesi i detyrës i kryetarit të OVLUÇK-së, Faton Klinaku, ka reaguar ndaj dhënies së dënimit prej 26 vjetësh për ish-komandantin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Salih Mustafa, nën pretendimin se ka kryer krime lufte. Klinaku ka theksuar se Gjykata Speciale bazohet në dëshmitarë të fshehur nga populli e dënon në emër të popullit. Ai ka thënë se lufta e UÇK-së ishte e drejtë, e pashmangshme dhe e domosdoshme. "Gjykatë që punon për t'i pajtuar shqiptarët e serbët. Lufta e UÇK-së ishte e drejtë, e pashmangshme dhe e domosdoshme, ndërsa ata pseudoprokurorë e pseudogjykatës të kërkojnë më shumë mjete financiare për të vepruar edhe për shumë vite, sepse ne nuk do të fshihemi asnjëherë nga populli ynë dhe me këto politika ndërkombëtare kursesi nuk do të pajtohen palët, e për çdo rast ne bëjmë përsëri luftë të drejtë, të pashmangshme dhe të domosdoshme, e ata pastaj të na dënojnë vetëm në emër të popullit serb", ka shkruar Klinaku

në "Facebook". Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Armend Mehaj, ka thënë se vendimi për dënim është "i padrejtë" dhe "i pabazë".

Ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se beson fuqishëm në pafajësinë e UÇK-së. "Unë besoj fuqishëm në pafajësinë e UÇK-së. Kosova e ka pranuar drejtësinë si mekanizëm për heqjen e të gjitha dilemave se lufta e UÇK-së për lirinë e vendit ka qenë luftë e pastër! Dënimi i sotëm i Sali Mustafës është vetëm një shkallë e drejtësisë, dhe rasti i tij në një shkallë tjetër, shpresoj ta marrë një epilog tjetër për lirinë e tij, siç ka ndodhur në plot raste të tjera, që dënimet drakoniane janë rikthyer në pafajësi", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se dënimi me 26 vjet burgim për Salih Mustafën ka nxitur indignatë te secili shqiptar. "Ky vendim i sotëm shpresojmë se do të korrigjohet në shkallën e dytë për ta dëshmuar seriozitetin dhe paanshmërinë e Gjykatës. Drejtësisë i kemi besuar gjithmonë dhe drejtësia, pashmangshëm, herëdokur, duhet dhe do ta gjejë rrugën e vet të vërtetë", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Kryetari i Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur", Bardhyl Mahmuti, ka reaguar ndaj këtij vendimi, duke theksuar se nuk mund të pritët drejtësi nga një gjykatë politike. "Dënimi i padrejtë i Nasim Haradinajt, Hysni Gucati dhe i Sali Mustafës dëshmon se gjykata e krijuar mbi bazën e sajësive politike nuk u bë për t'i hequr akuzat shpifëse ndaj UÇK-së, por për ta vënë atë në bankën e akuzës dhe për ta dënuar! Pa zhbërjen e kësaj sajese politike nuk do të ketë drejtësi!", ka shkruar Bardhyl Mahmuti në "Facebook".



FLET PËR "EPOKËN E RE", HISEN BERISHA

Serbia në veri po imiton Rusinë para se ajo ta sulmonte Ukrainën

- Plani franko-gjerman i shërben Serbisë për ruajtjen e status-quo

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Hisen Berisha, ka thënë se Serbia është duke e imituar Rusinë në veri të Kosovës para se ajo ta sulmonte Ukrainën. Sipas Berishës, situata në veri është me rrezikshmëri të lartë. Në këtë intervistë dhënë "Epokës së re", Berisha ka thënë se ShBA-ja dhe BE-ja duhet t'i detyrojnë serbët jo vetëm t'i largojnë barrikatadat, por edhe t'i dorëzojnë kriminelët që kanë organizuar plagosjen e policit dhe nxitur tensionimin e situatës në veri. Në këtë kontekst, Berisha është shfaqur kritik ndaj qeverisë Kurti, e cila, sipas tij, i ka lëshuar terren Vuçiqit duke ia krijuar arsyeshmërinë për vendosjen e barrikatave dhe nxjerrjen nga administrimi shtetëror të 17 përqind të territorit të Kosovës

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 DHJETOR -

"Epoka e re": Z. Berisha, edhe pas vizitës së emisarit amerikan Gabriel Escobar në Kosovë dhe deklaratës së tij që të hiqen barrikatadat, situata në veri mbetet e njëjtë. Pse po ndodh kjo?

Berisha: Deklarata e Escobarit ishte decizive dhe kërkonte largimin politik të barrikatave. Arsyeja pse edhe pas këtij qëndrimi të diplomatit amerikan, gjendja në veri mbetet e njëjtë, është pikërisht pamjaftueshmëria politike e

deklaratave të të dërguarit special të ShBA-së. Pas kësaj situatë të krijuar në veri, të dërguarit special nga ShBA-ja dhe BE-ja do të duhej të urdhëronin përmes mekanizmave të NATO-s largimin e barrikatave nga ana e KFOR-it dhe, sipas vlerësimit, të kërkonin shtimin e trupave ushtarake të NATO-s dhe të fillojnë procedurat që Kosova menjëherë të kalojë në gjendje të jashtëzakonshme të sigurisë.

Rreziku është i lartë! Ka shumë analogji se Serbia në veri të Kosovës po imiton Moskën, para se ajo ta sulmonte Ukrainën. Nëse

atje ka ndodhur pikërisht ky skenar, përkundër paralajmërimeve dhe vërejtjeve kërcënuese të bashkësisë ndërkombëtare, nuk ka asnjë garanci që Kosova të mbrohet vetëm nga deklaratat. Diplomati amerikan dhe i BE-së duhet t'i detyrojnë serbët jo vetëm t'i largojnë barrikatadat, por t'i dorëzojnë kriminelët që organizuan plagosjen e policit kosovar dhe tërë këtë situatë luftënxitëse atje. Escobar nuk e fshehu, përkundrazi e elaboroi edhe mënyrën se si do të formohet asociacioni dhe nëse qeveria aktuale nuk e formon deri në prill të vitit 2023 atëherë do të shikohet mundësia alternative për ta kapërcyer këtë pengesë të stisur. Bazuar në këtë deklaratë dhe përgjithësisht bazuar në angazhimin amerikan lehtë mund të konstatojmë se Qeveria e Republikës së Kosovës i ka lëshuar terren Vuçiqit duke i krijuar gjithë arsyeshmërinë për vendosjen e barrikatave dhe nxjerrjen nga administrimi shtetëror të 17 përqind të territorit të Republikës së Kosovës.

Dua t'i rikujtoj deklaratat e mëhershme kur zyrtarë amerikanë me zë e figurë i kërkuan Qeverisë së Republikës së Kosovës shtyrjen deri në prill të zbatimit të

urdhërësës për targa, kthimin e serbëve në institucione dhe nisjen e bisedimeve për krijimin e asociacionit, kërkesë kjo e serbëve lokalë dhe e Beogradit zyrtar. Si konkluzion, pra deri sot asnjë nga faktorët diplomatikë ndërkombëtarë nuk e ka mbështetur kundërshtimin e Albinit për formimin e asociacionit.

"Epoka e re": Projekti franko-gjerman deklarativisht është pranuar nga spektri politik, ndërsa ju po mbani qëndrim skeptik dhe kundër tij. Cilat janë objektivat tuaja dhe a ka qëndrim PDK-ja rreth këtij dokumenti?

Berisha: Në kohën kur qeveria Hoti ka nënshkruar në Uashington marrëveshjen e mirëkuptimit dhe kur në njërin nga pikat e asaj marrëveshjeje thuhej se Kosova heq dorë nga lobimi për njohje për një vit, ky pra, Albini, e vendosi Hotin në tabelë qitjeje dhe provojë ta njollosë, duke përdorë ofendime pa asnjë argument. Plani që ju i referoheni nuk parasheh njohjen reciproke, bile përkundrazi versioni i fundit as që e përmend njohjen. Nëse lexohet ashtu siç na është prezantuar, nënkupton se këtë plan e ka shkruar Vuçiqi mbështetur në deklaratat e tij publike se "Serbia asnjëherë në

nuk e njeh shtetin e Kosovës". Varianti i kaluar diferonte nga ky, ngaqë në atë variant s'paku pas dhjetë vjetësh Kosovës i lindte e drejta për t'ia kërkuar njohjen Serbisë, kurse varianti i fundit e ka fshirë dhjetëvjeçarën dhe në interpretimin tim e kthen Republikën e Kosovës në 'Republikën e tretë', që juridikisht do të thotë e shndërron Kosovën në 'Krahinë jugore të Serbisë'. Aktualisht ky plan i shërben Serbisë për ruajtjen e status quo-s. Mund ta konsiderojnë 'si bazë solide për vazhdimin e dialogut', por ky plan nuk shkon përkrah kërkesës eksplicite të Amerikës për zgjedhjen përfundimtare të çështjes. Ne duhet koordinim me diplomacinë amerikane për ta mbrojtur shtetin e Kosovës prej pazareve me Vuçiqin. Opozita duhet të kërkojë që dialogu ta prodhojë zgjidhjen përfundimtare me njohje reciproke.

"Epoka e re": Pas aplikimit për anëtarësim në Këshillin e Evropës, qeveria ka aplikuar edhe për anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin Evropian (BE). Cilat janë pritjet tuaja nga këto dy procese?

Berisha: Aplikimi i Qeverisë së Kosovës për në BE është një dëllir politik i neokomunistëve dhe këta

Kurti në pritje të KFOR-it për heqjen e barrikadave

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se është ende në pritje të KFOR-it për heqjen e barrikadave në veri të Kosovës. “Më së miri do të ishte që të hiqen nga ata që i kanë vendosur, mirëpo ata që i kanë vendosur ato barrikada janë vendosur edhe vetë në barrikada, madje me armatim. Nuk janë këto barrikada civile dhe, në anën tjetër, ne kemi dhënë kohën e kërkuar prej KFOR-it që ata ta bëjnë heqjen e këtyre barrikadave, dhe ministri ynë i Punëve të Brendshme po

pret”, ka thënë Kurti në një intervistë për televizionin lokal në Kosovë, ATV.

Ai ka thënë se barrikadat në veri të Kosovës nuk mund të qëndrojnë aty, “jo vetëm pse shkelin ligjin dhe lëvizjen e lirë, por në të njëjtën kohë edhe për shkak se vetë qytetarët serbë janë më të bllokuarit”.

I dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se pret që barrikadat e ngritura në veri të Kosovës të hiqen nga personat që i kanë krijuar ato.



Von Cramon thotë se integrimi i Kosovës në BE varet edhe nga dialogu me Serbinë

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, ka thënë se aplikimi i Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian është hap i rëndësishëm, por ka

shtuar se integrimi në bllok varet edhe nga dialogu me Serbinë. “Është thelbësore që gjithë Ballkani Perëndimor të futet në BE. Ritmi i integritit të Kosovës në BE do të varet nga përkushtimi i saj për

miratimin e reformave të nevojshme dhe përfundimin e suksesshëm të dialogut me Serbinë, të udhëhequr nga Bashkimi Evropian”, ka shkruar në “Twitter” Viola von Cramon.

e bën aktin sa për ta zënë radhën. Sipas zhvillimeve të fundit, mendoj se Albin Kurtin do ta përzënë nga “aplikimi i neokomizmit autoritar” dhe ky akt në ndonjë të ardhme, që për mua është shumë e largët, atyre ka për t’u shërbyer si retorikë populiste, se gjoja ne po bënim diçka për Kosovën. Ajo që është më irrituese është loja e koordinuar e lidhshimit vendor për ta injoruar situatën në veri duke e prezantuar si normale (thua se janë të koordinuar drejtpërdrejtë me Beogradin e Vuçiqin, që atje të mbetet gjithçka nën kontroll dhe në binarët e normales).

Në këtë kontekst e shoh edhe ceremoninë patetike të aplikimit për statusin e vendit kandidat për në BE. Ky lajm është vërtet ngushëlues dhe s’ka asnjë efekt pozitiv, përveç efektit populist që qeveria do ta përdorë në politikën e brendshme si tentim për t’i bërë një makijazh fytyrës së saj të diskredituar e të dështuar, si në planin ekonomik ku inflacioni shkon mbi 20 për qind, ndërsa erdhi në pushtet me megalomaninë e rritjes ekonomike dyshifrore. Ndërkaq në planin e sigurisë kombëtare 17 për qind e territorit të Republikës së Kosovës për shkak të tërheqjeve të Albinit nga vendimet e pabarmonizuara me partnerët ndërkombëtarë, sot administrohet nga kriminelë serbë. Në planin diplomatik ndërkombëtar, Qeveria e Kosovës për herë të parë është shumë herë më e kritikuar se secila qeveri e Serbisë në të kaluarën.

Për herë të parë diplomacia botërore tërheq vërejtje për moszbatim të marrëveshjeve të nënshkruara, shqiptarëve të Kosovës, shtu kësaj dështimit me

vizat, mosnjohja e Kosovës nga asnjë shtet që prej neokomunistët qeverisin Kosovën etj.! Pra, me të gjitha këto dështime, kjo ceremoni dhe ky aplikim, është sikur puna e fëmijëve të gëzuar nga rënia e dëborës së parë që mbarojnë dordolecin në oborr, e kur të kthehen nga shkolla dordoleci ka shkrirë e në oborr e gjejnë vetëm fshesën, specin e kuq në vend të hundës dhe tenxheren që ia kishin vendosur dordolecit në kokë.

Ndërsa politikisht, efekti i këtij aplikimi do të shpërfaqet kur Serbia dhe Kosova përmes projektit franko-gjerman në kuadër të marrëveshjes finale do të përfshihet integrimi i përbashkët i Serbisë me Kosovën në BE dhe krijimin e asociacionit. Do të thotë se Kosova do të integrohet në BE bashkë me Serbinë, pa detyrimin paraprak të Serbisë për ndryshim të Kushtetutës, ku Kosovën e mbahet si pjesë integrale të saj.

Në leximin skaner që i duhet bërë kësaj vepre, qartazi del se këta janë shndërruar në shërbëtorë të doktrinës së “botës serbe” dhe po fshehin përmes kësaj kërkesë rrënimin e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës dhe krijimin e Republikës së Tretë. PDK-ja ka skepticizëm për arsye se ajo nuk do të ngre drojën te kombi shqiptar dhe të ndikojë në boshatisjen e Kosovës që po ndodh si shkak i gjendjes së mjeruar ekonomike. Pra thjeshtë, Partia Demokratike po mundohet me qenë shpresa e këtyre shqiptarëve që kanë mbetur ende të frymojnë në këtë shtet, edhe për këtë reagim i PDK-së është diçka më elegant sesa reagimi im.



“Epoka e re”: Z. Berisha, Vuçiqi ka adresuar kërkesë në NATO për kthimin e 1 000 trupave ushtarake jugosllave në Kosovë? Sa është e mundur kjo dhe cilat do të ishin konsekuencat e një veprimi të tillë?

Berisha: Së pari, bota ushtarake e mbledhur në Aleancën e NATO-s nuk njih asnjë ushtri jugosllave. Së dyti, asnjë serb, asnjë monument kulture, asnjë institucion nuk është pre e veprave të “gjenocidit” kosovar ndaj tyre. Asnjë nga shërbimet e inteligjencës nëpër botë nuk mund të gjejë askund ndonjë organizim shqiptarësh që ka në plan vrasjen apo luftimin e serbëve shtetas të Republikës së Kosovës që jeton në respektim të ligjeve dhe rendit kushtetues e shtetëror. Sa i përket veprimeve të Policisë së Kosovës aty me asnjë logjikë nuk mund të arsyetohen si reprezalje shtetërore ndaj një komuniteti joshqiptar. Serbi i fundit i arrestuar është autori i akteve terroriste kundër institucionit shtetëror të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), e edhe sikur të

kishte kryer këtë vepër midis Serbisë ai njeri do të duhej të ishte në burg. Kështu që, kjo kërkesë e Vuçiqit për mua është më shumë prodhim artificial me të cilin do që të arrijë ta shtyjë ose maksimalisht ta shuajë fare kërkesën e faktorit ndërkombëtarë karshi Serbisë për të vendosur sanksione kundër Rusisë. Kurse në planin e brendshëm, ai dëshiron ta kthejë Marrëveshjen e Kumanovës nga marrëveshje e kapitullimit të ushtrisë serbe në një akt të fitores se asaj ushtrie, e cilësuar si gjenocidiale dhe e bombarduar nga civilizimi modern për 78 ditë deri te dita e kapitullimit ushtarak të nënshkruar në Kumanovë më 10/06/99.

“Epoka e re”: Sa është i afërt momenti kur Kosova do të jete pjesë e Partneritetit për Paqe? A do të ishte ky një hap drejt integritit në NATO dhe një arritje e madhe në fushën e sigurisë?

Berisha: Secili shtet ka rrugën e vet të përparimit. Gjykuar nga historitë e shteteve të tjera anëtare të NATO-s

ose atyre që pretendojnë të bëhen anëtare të NATO-s duhet të mos nxisim për Kosovën asnjë shpresë mashtrimi. Unë si ushtarak po ju them se jemi ende larg këtij anëtarësimi. Inflacioni 30 për qind, konteksti territorial i pazgjidhur, mosnjohja nga disa shtete të rëndësishme anëtare të NATO-s nuk janë vetëm pengesa teknike. Shqiptarët në Kosovë nuk duhet të deprimohen nga këto që po them derisa ndonjë “patriot” nga pozita drejtuese shtetërore nuk bën që KFOR-i të largohet nga shteti ynë (nuk është e largët dita kur jemi kërcënuar, jo shantazhuar me këso lëvizje). Prandaj unë them se ne duhet të avancojmë të gjitha zhvillimet në shtet e të punojmë intensivisht. Ukraina po i nënshtrohet sulmeve okupatore ruse vetëm pse dëshironte anëtarësimin në NATO. Shtetet skandinave që po presin t’i kalojnë hapat për anëtarësim, janë shembull sesa pak alibi duhet të pengohemi në hapjen e derës në NATO!

Pra, ne duhet zhvilluar kapacitetet ushtarake, sipas planit të miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës e të mos i sabotojmë ato. Nëse i përcjellim planifikimet në aspektin ushtarak, Kosova mbetet shtet i pa okupuar nga Serbia. Nëse e avancojmë me prioritet rritjen ekonomike dhe të GDP-së, ne do ta shkurtojmë secilën rrugë të integritit euroatlantik dhe Republikës së Kosovës. Thjeshtë dhe kuptueshëm pa zhvillim ekonomik askush mos të shoh ëndrra kolor! Prandaj edhe angazhimi i diplomacisë amerikane konsiston në një strategji të investimeve dhe zhvillimit ekonomik, e cila do t’i shuante përplasjet politike.

Akademikë e profesorë e konsiderojnë goditje për UÇK-në dënimin nga Specialja të Salih Mustafës

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës ka promovuar të premten librin "Ushtria Çlirimtare e Kosovës - vlerë kombëtare". Ky është botim i përbashkët me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë si dhe Institutin Albanologjik të Prishtinës.

Për librin kanë folur Muhamet Mavraj dhe Abdulla Azizi. Të pranishëm në këtë promovim ishin edhe deputetë të Kuvendit të Kosovës si dhe akademikë e profesorë, të cilët e konsideruan goditje për UÇK-në dënimin nga Specialja të Salih Mustafës. Sipas tyre, Ushtria Çlirimtare e Kosovës bëri luftë të pastër dhe u themelua një vit përpara se të fillonte lufta e Kosovës më 28 nëntor të vitit 1997.

Bedri Zyberaj, drejtor ekzekutiv i Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës, tha se "goditjen e parë nga Dhomat e Specializuara në Hagë e morëm sot, pas dënimit të luftëtarit Salih Mustafa me 26 vjet burgim", tha ai.

Ndërsa rektori i Universitetit të Tetovës, Abdulla Azizi, tha se ky libër është me rëndësi sepse i kushtohet UÇK-së. "Rëndësia e



këtij botimi del që po i kushtohet rëndësi luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", ka pohuar ai, raporton EO. Muhamet Mavraj, publicist dhe referues, tha se e gjithë lufta e UÇK-së është cenuar, duke

shtuar se po të ishte gjallë edhe Adem Jashari, do të trajtohej njëlloj. "Edhe gjatë luftës edhe në luftë kemi pasur luftë brenda dhe jashtë Kosovës. Edhe pas luftës përmasat morën një kaheje tjetër, e këto përmasa

morën rrugën deri te Haga. Edhe Adem Jashari po të ishte sot, do të ishte figura më e cenuar", ka deklaruar Mavraj. Ardit Bido, drejtor ekzekutiv i Arkivave të Shqipërisë, tha se dënimi i Calit është gabim i

Speciales e që, sipas tij, duhet bërë titur si po ndodhin këto gjëra. "Rasti i UÇK-së që po ndodh sot në Hagë është për të bërë titur se si po ndodhin këto lloj gabime ciklike", është shprehur Bido.

EULEX-i konfirmon se i është kërkuar të ndërmyetësojë në transferimin e Pantiqit

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Misioni i Bashkimit Evropian në Kosovë për Sundim të Ligjit (EULEX) ka konfirmuar se ka marrë kërkesë nga institucionet e Kosovës për të ndërmyetësuar në transferimin e ish-policit serb Dejan Pantiq.

"Në linjë me mandatin e tij, EULEX-i po monitoron rastin e D.P.", është thënë në përgjigjen e EULEX-it dhënë për "Radion Evropa e Lirë".

Dejan Pantiq, ish-pjesëtar i Policisë së Kosovës, është arrestuar më 10 dhjetor në pikën kufitare të Jarinjës, që lidh Kosovën me Serbinë.

Autoritetet në Kosovë dyshojnë se ai ka organizuar "sulmin terrorist" ndaj zyrave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në veri të Kosovës më

6 dhjetor.

Ndaj tij, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 12 dhjetor, ka shqiptuar një muaj paraburgim. Institutet e Kosovës nuk kanë bërë me dije se ku po mbahet Pantiqi.

As EULEX-i nuk ka bërë me dije se ku po mbahet ai ose si do të veprojnë lidhur me kërkesën për transferimin e tij.

EULEX-i ka theksuar se, përveç Policisë së Kosovës, Prokurorisë Speciale dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, ky mision është në kontakt edhe me avokatin e Pantiqit, "i cili ka kërkuar nga misioni që ta monitorojë rastin". "Në linjë me mandatin tonë, misioni po monitoron këtë rast për



të vlerësuar se si po trajtohet nga autoritetet e Kosovës. Ne

përsërisim se është shumë e rëndësishme që të drejtat e D.P të

respektohen plotësisht në bazë të ligjit", është thënë në përgjigje.

Ministria e Punëve të Brendshme nuk i ka dhënë ndonjë informacion "REL"-it se në cilin vend apo qendër paraburgimi gjendet ai. Këtë informacion nuk e kanë as familjarët, avokati i tij dhe as Avokati i Popullit të Kosovës.

Avokati i Pantiqit, Nebojsa Vllajiq, ka pretenduar se klientit të tij po i shkelen të gjitha të drejtat e njeriut.

"Ai ka të drejtë të vizitohet nga një avokat, ta vizitojë familja e tij, të marrë trajtim (mjekësor) dhe gjithçka tjetër. E gjithë kjo është mohuar për faktin se nuk dihet se ku është. E vërteta e vendndodhjes së tij duhet të publikohet", ka thënë Vllajiq për "Radion Evropa e Lirë".

Mehaj për FSK-në: Do të jetë në çdo cep të territorit të Kosovës, varësisht nevojave

PRISHTINË, 16 DHJETOR (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka deklaruar se Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) do të jetë në çdo cep të territorit të vendit varësisht nevojës. Këtë deklaratë Mehaj e ka dhënë gjatë konferencës së fundvitetit kur është pyetur nga gazetarët për mungesën e pranisë së ushtarakëve të Kosovës në veri në bazë të një marrëveshjeje të mëhershme. Në këtë konferencë Mehaj ka folur edhe për arritjet e këtij viti si dhe për aspiratën për t'u bërë pjesë e

programit të Partneritetit për Paqe të NATO-s.

Mehaj ka thënë se mandati i Forcës së Sigurisë së Kosovës është i dedikuar për ta mbrojtur të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. "Ajo marrëveshje është nënshkruar në vitin 2013. Përmes mandatit dhe ligjeve të Kosovës, FSK-ja është e dedikuar për ta mbrojtur territorin e Republikës së Kosovës. Kudo që është nevoja FSK-ja do të jetë. Kudo që është nevoja FSK-ja do të jetë për mbrojtjen e territorit të

Republikës së Kosovës", ka thënë Mehaj, duke shtruar se raportimet se FSK-së i kufizohet pajisja me armatim të rëndë nuk qëndrojnë. "FSK-ja ka armatim të rëndë dhe kemi armatim edhe më të rëndë. Nuk kemi kufizime siç pretendojnë me qëllime të ndryshme. FSK-ja çdo pajisje që ka, por edhe program, është me standarde të NATO-s. Prokurohet prej shteteve e partnere të NATO-s, shumica prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës", ka thënë Mehaj.



KFOR-it i është dorëzuar kërkesa për trupat serbe në Kosovë

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Radiotelevizioni i Serbisë ka raportuar të premten se misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, i është dorëzuar kërkesa për dërgimin e pjesëtarëve të forcave serbe të sigurisë në territorin e Kosovës. Sipas raportimeve, kërkesa është bërë në Merdar, një prej pikëkalimeve mes Kosovës dhe Serbisë.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka bërë me dije të enjten se Qeveria e

Serbisë do t'ia nisë KFOR-it këtë kërkesë në formë elektronike. Sipas tij, bëhet fjalë për kthimin e 100 deri në 1 000 trupave të ushtrisë dhe policisë serbe në Kosovë. Beogradi e ka marrë këtë vendim pas pranisë së shtuar të Policisë së Kosovës në rajonin verior. Beogradi zyrtar e arsyeton këtë kërkesë duke iu referuar Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Vetë Vuçiqi ka thënë se pret që kërkesa të mos i pranohet,

duke u bazuar në mesazhet që kanë dhënë zyrtarët ndërkombëtarë ditët e fundit.

I dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se Kosova ka garanci shumë të forta të sigurisë nga Shtetet e Bashkuara. Ai ka deklaruar se ShBA-ja e kundërshton dhe e refuzon në mënyrë kategorike kërkesën e Serbisë për kthimin e forcave të saj në Kosovë.



KDI-ja: Legjislacioni mbi financimin politik, ende me mangësi

EPOKA
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka organizuar tryezën e diskutimit mbi situatën lidhur me financimin e subjekteve politike në Kosovë pas ndryshimeve të fundit ligjore në këtë fushë. Ismet Kryeziu, drejtor ekzekutiv i KDI-së, fillimisht falënderoi Republikën Çeke për mbështetjen e Kosovës në të gjitha dimensionet, në veçanti lidhur me përpjekjet për avancimin e transparencës dhe llogaridhënies financiare të

subjekteve politike.

Ambasadori i Republikës së Çekisë në Kosovë, Pavel Bilek, vlerësoi lart bashkëpunimin e deritanishëm mes institucioneve dhe organizatave joqeveritare të Kosovës dhe atyre të Republikës Çeke, duke theksuar se ky bashkëpunim ka mundësuar kryerjen e kontrollit financiar të subjekteve politike në përputhje me standardet evropiane.

Kreshnik Radoniqi, kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, theksoi se transparencia financiare e partive politike është e domosdoshme për të siguruar besueshmëri të

qytetarët për partitë politike, por edhe për të garantuar llogaridhënie të qytetarët për paratë që këto parti politike marrin nga buxheti i shtetit apo edhe nga donatorë të tjerë. Për më shumë, ai paraqiti veprimet e ndërmarra nga KQZ-ja, me të cilat i është kontribuar transparencës. Në anën tjetër, Ondrej Kopečný, drejtor ekzekutiv i Transparency International në Republikën Çeke, theksoi se miratimi i ligjit përbën vetëm zhvillimin e parë para fillimit të vështirësive në zbatim praktik të tij. Ai nënvizoi nevojën që zyra të ketë udhëheqje profesionale dhe të pavarur.

Gjatë diskutimit, KDI prezantoi edhe punimin "Financimi Politik në Kosovë: Çka pas ndryshimeve të fundit ligjore?". Eugen Cakolli, autor i këtij punimi, theksoi që përmbyllja e sagës së plotësim-ndryshimit të legjislacionit mbi financimin politik në Kosovë, përbën zhvillim pozitiv dhe përparim drejt transparencës dhe llogaridhënies financiare të subjekteve politike. Sidoqoftë, sipas tij, jashtë gamës dhe rregullimit ligjor ende kanë mbetur disa çështje akute dhe problematike, siç janë financat e kandidatëve të subjekteve politike, shpenzimet për fushatat

elektorale 'online' si dhe fushatat nga palët e treta.

Për më tepër, zbatueshmëria e këtij ligji në praktikë do të testohet vetëm pasi të jetë konsoliduar dhe funksionalizuar zyra që do ta bëjë kontrollin e financave të subjekteve politike.

Në fund, u rekomandua që, mes të tjerash, çështjet e mbetura lidhur me financimin e subjekteve politike të përfshihen në procesin aktual të reformës zgjedhore; që subjektet politike të kenë xhirrologari plotësisht transparente; si dhe që të kategorizohen gjobat ndaj subjekteve politike.

Arrestohet një serb i dyshuar për krime lufte

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Policia e Kosovës ka arrestuar më 15 dhjetor një person nga komuniteti serb, nën dyshimin për krime lufte kundër popullsisë civile, është thënë në një komunikatë për medie të këtij institucioni.

Arrestimi i tij është thënë të jetë bërë bazuar në deklaratat e

dëshmitarëve dhe informacioneve në rrugë operative.

Me vendim të prokurorit, i ndaluar është dërguar në mbajtje.

Policia e Kosovës nuk e ka bërë me dije identitetin e tij.

Ndërkohë, drejtori i Zyrës për Kosovën në qeverinë serbe,

Petar Petkoviç, ka thënë se i arrestuari është ish-polici serb, Slllogjan Trajkoviç. "Si po shfaqen papritmas provat kundër serbëve, sapo u larguan nga institucionet, e që nuk ekzistonin derisa ishin pjesë e institucioneve të Kosovës", ka shkruar Petkoviç në "Twitter".



Qeveria miraton draftin e strategjisë së energjisë 2022-2031

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Qeveria e Kosovës ka miratuar të premten draftin e Strategjisë të Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031.

Sipas këtij drafti, vizioni i Strategjisë së Energjisë është për një sektor energjetik të qëndrueshëm dhe të integruar në tregun pan-evropian, që garanton siguri të furnizimit me energji elektrike dhe të përballueshme për qytetarët. Kjo strategji ka pesë objektiva strategjike dhe bashkë me synimet e tyre specifike përbëjnë thelbin e Strategjisë sonë të Energjisë: Objektivi strategjik 1: Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit; Objektivi strategjik 2: Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtërishme; Objektivi strategjik 3: Rritja e efikasitetit të energjisë; Objektivi strategjik 4: Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut; dhe Objektivi strategjik 5: Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve. Në këtë mbledhje është miratuar edhe Projektligji për ndryshimin

dhe plotësimin e Ligjit për Energjinë. Ky projektligj ka për qëllim t'i bëjë ndryshimet e nevojshme të Ligjit për Energjinë për t'i përcaktuar masat e kursimit të energjisë gjatë periudhës së masave emergjente, mbikëqyrjen e zbatimit të masave të kursimit si dhe dispozitat ndëshkuese.

Gjithashtu, është miratuar edhe koncept-dokumenti për rininë i cili rekomandon avancimin dhe fuqizimin e rinisë në Kosovë. Bazuar në regjistrimin e fundit, të dhënat tregojnë se 19.3 % e popullsisë së përgjithshme në Kosovë është e grupmoshës 15-24 vjeç.

Kabineti qeveritar ka votuar edhe për Programin Edukativ për nxënësit e klasës së njëmbëdhjetë në Republikën së Kosovës në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë "Edukimi për Siguri". Ky program ka për qëllim edukimin dhe trajnimin e të rinjve të Republikës së Kosovës në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ai parashihet të zhvillohet me nxënës të shkollave të mesme të Republikës së Kosovës.

Qeveria ka miratuar vendimin e propozuar nga Ministria e



Financave, Punës dhe Transfereve për rialokim të mjeteve të mbetura dhe të kursyera buxhetore në shumën prej 4.8 milionë eurove. Po ashtu, është votuar edhe për kërkesën e Telekomit për huamarrje, sipas së cilës, Telekom i siguron një hua në

Financave, Punës dhe Transfereve për rialokim të mjeteve të mbetura dhe të kursyera buxhetore në shumën prej 4.8 milionë eurove. Po ashtu, është votuar edhe për kërkesën e Telekomit për huamarrje, sipas së cilës, Telekom i siguron një hua në

Financave, Punës dhe Transfereve për rialokim të mjeteve të mbetura dhe të kursyera buxhetore në shumën prej 4.8 milionë eurove. Po ashtu, është votuar edhe për kërkesën e Telekomit për huamarrje, sipas së cilës, Telekom i siguron një hua në

Kuvendi miraton buxhetin për vitin 2023



Deputetët e Kuvendit të Kosovës me 65 vota për e kanë miratuar në lexim të dytë Projektbuxhetin për vitin 2023. Ky buxhet pritet të jetë 3 miliardë e 212 milionë euro

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Kuvendi i Kosovës ka votuar në lexim të dytë Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023. Kryetari i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere, Armend Muja, ka paraqitur dhe arsyetuar raportin e komisionit për këtë projektligj, duke kërkuar që të miratohen amendamentet e propozuara nga komisioni funksional. Mbështetje për këtë projektligj ka kërkuar edhe ministri i Financave, Hekuran Murati. "Projektligji mbi ndarjet buxhetore për vitin

2023 është një buxhet më i larti ndonjëherë dhe kap vlerën mbi 3.2 miliardë euro ose 3 miliardë e 212 milionë euro, mirëpo nëse merren parasysh edhe amendamentet që kanë kaluar në komision, atëherë kjo e kalon shifrën prej 3 miliardë e 225 milionë eurosh", ka thënë Murati. Ai ka theksuar se gjatë shqyrtimit kanë qenë disa ndryshime për të akomoduar disa projekte dhe se ka pasur disa korrigjime të cilat janë bërë bashkërisht në komisionin funksional. Sipas tij, ky buxhet plotëson prioritetet e qeverisë dhe nevojat e qytetarëve.

Escobari thotë se ShBA-ja përkrah integrimin ekonomik të tregjeve rajonale

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Zëvendësndihmëssekretari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Çështjet Evropiane, Gabriel Escobar, ka takuar anëtarët e Bordit të Guvernatorëve të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë. Zëvendësndihmëssekretari amerikan ka përsëritur përkushtimin e Shteteve të Bashkuara për ta përkrahur

integrimin euroatlantik të të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor ashtu si dhe integrimin ekonomik të tregjeve rajonale.

Përfaqësuesit e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë prezantuan para Escobarit, i cili njëherësh është edhe përfaqësues i Posaçëm i Shteteve të Bashkuara për Ballkanit Perëndimor, qëndrimin e

Odës Amerikane në mbështetje të normalizimit ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si dhe të gjitha iniciativat për tregun e përbashkët rajonal si Ballkani i Hapur dhe Procesi i Berlinit. Udhëheqësit e Odës Amerikane shprehën shqetësimet e tyre lidhur me tensionet në rajon si pengesë për aftësinë e Kosovës për të tërhequr investime.



RRËFIME NGA DITARI I LUFTËS

Takimi i fundit me komandantin, Hyzri Talla



HYZRI TALLA,

ILIR DURMISHI

AFRIM MALIQI

Haqif MULLIQI

Mëngjesi i 28 nëntorit i vitit 1998. Vit luftime. Sapo kishte aguar, me tim vëlla, Hakiun mbërritëm në Llapashticë. Ishte një nëntor feste me borë dhe këtë nuk do ta harroj përjetë. Jo për shkak të të ftohtit të acartë që na përcëllonte mbi fytyrë, nga vendi ku e parkuam kerrin, e deri tek Shtabi i UÇK-së të Zonës Operative të Llapit, që, prej disa muajsh ishte vendosur në një shtëpi dykatëshe në Llapashticë, por, nga fakti se, asaj dite, e pata takimin e fundit me Heroin e Kosovës dhe luftëtarin e rrallë, Hyzri Tallën.

S'do men se, unë Hyzriun e njihja që më parë. Ndërsa, gjëja që e dija për të, para luftës, apo edhe diçka që mund ta pandehja, ishte se ai, sigurisht po militonte në radhët e Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK) me ilegalët dhe militantët e së cilës tashmë kisha kontakte të afërta dhe një formë të bashkëpunimit që nga viti 1995. Pandehma për këtë më bëhej më e besueshme edhe nga fakti se familja e Hyzriut dhe ajo e Fatmir Humollit kanë lidhje familjare.

Hera e parë kur qëndruam bashkë, për më gjatë, ishte ajo e natës së tretë të betejës së famshme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Qafë të Kaçanollit, betejë në të cilën për ato ditë sa zgjati isha pjesëmarrës edhe unë. Në atë betejë, Hyzriu qe plagosur. Poende asaj nate të messhtatorit,

në zyrat e Shtabit të Zonës Operative të Llapit (ZOLL), në Majac, me Hyzriun biseduam gjerë e gjatë për shumëçka: për luftën tonë, për betejën e fundit, për LKÇK-në, për betejën e Hades, për Ademin dhe Hamzën, për Prekazin dhe miqtë e tij (gruan e ka të familjes së luftëtarëve të shquar nga ky fshat – Lushtaku) dhe për mikun e tij të ngushtë, gazetarin Afrim Maliqi.

“Afrimin e kam mik për krye kreje”, më tha Hyzriu.

“Është vërtetë një njeri shumë i mirë dhe profesionist i medias”, ia ktheva unë.

Mirëpo, ndërsa, të vetmen gjë që nuk e zuri në gojë, asaj nate, ishte plaga që e kishte marrë në betejën e jashtëzakonshme të UÇK-së kundër serbëve, në ditët që i kishim lënë pas e në të cilën nga radhët tona ishin vlarë shtatë ushtarë pjesëtarë të Brigadës 152 “Shaban Shala”: Bekim Maliqi nga Batllava, Bekim Lushaku nga Hërtica, Habib Zeka nga Rakinica, Fadil Sejdiu nga Bradashi, Nazmi Zhegrova nga Llapashtica e Ulët, Ismail Rekaliiu nga Dobratini dhe Selim Rekaliiu po ashtu nga Dobratini.

Bisedat e asaj nate në Majac nuk kishin fund, në atë zyrë tipike ushtarake, në të cilën veç nesh ishin edhe Komandant Remi (Rrustem Mustafa), Komandant Daja (Kadri Kastrati), Komandant Fati (Latif Gashi), Komandant Luta (Idriz Shabani), Komandant Batusha (Tafil Avdiaj) dhe Baci

(Fatmir Humolli). Një natë gati si nëpër përrallat e moçme shqiptare dhe një kujtim i pashlyer përjetësisht dhe një portret i paharruar për dëshmorin e Lirisë së Kosovës dhe shokët e tij të pushkës dhe të idealit.

Më pas, me Hyzriun jemi takuar shumë herë, para takimit tonë të fundit, të ditës së 28 nëntorit të vitit 1998, në Llapashticë. Jemi takuar në Majac, jemi takuar në Buricë dhe, s'do mend, edhe në shtabin e ZOLL, kur u vendos në Llapashticë, paralagje e Podujevës. Bile, një herë u takuam edhe në Shtabin e Zonës Operative të Shalës, në Ashlan, kur Hyzriu po u printe një grupi goxha të madh ushtarësh nga Llapi me të cilët po shkonte në furnizim për armë.

Gjatë shtegtimeve të mia nga një zonë e luftës në tjetrën, kudo nëpër Kosovë, rrallë më ka rastisur të takoj luftëtarë të madhështisë së tij. Hyzriu ishte i veçantë. I urtë, i mençur dhe trim i pa shoq, ndërsa dy gjërat më të rëndësishme që e bënin të veçantë ishin: se u jepte një lloj sigurie bashkëluftëtarëve dhe se ishte i vendosur që çështjes sonë t'i shkonte deri në fund. I tillë ishte edhe në ditën e shenjtë të Festës së Flamurit të vitit të luftës 1998 kur u takuam së fundit herë.

Asaj dite, unë me Hakiun kishim marrë udhë për në Shalë (në shkollën e Bajgorës) ku ushtarët e Zonës Operative të Shalës kishin organizuar një manifestim për

nderë të 28 Nëntorit, ndërsa, me atë rast, mua ma ndanë një mirënjohje të shtabit të Zonës Operative të Shalës për kontributin tim në luftën çlirimtare. Por, para se të shkonim në Bajgorë, me Hakiun, vendosëm që ndalonim në Llapashticë, t'i takonim shokët tanë aty, dhe ta uronim njëri-tjetrit për festën e Pavarësisë së Shqipërisë si dhe të Flamurit tonë Kombëtar, ngase e ndjenim se ky ishte ai viti i mbarë për shqiptarët, ndërsa flamuri ishte frymëzim për të gjithë ne.

Pasi që e lamë kerrin, ecëm disa dhjetëra metra dhe ndaluan tek dyert e oborrit të shtabit. Ia uruam njëri-tjetrit festën dhe, menjëherë, vazhduam, nëpër atë të ftohtë të madh, për tek zyra e Komandant Remit. Njeriu i parë që e takuam në shtab, atij mëngjesi, ishte Hyzri Talla. Ai u befasua, por edhe u gëzua kur na pa. U morëm ngryk, siç merreshim rëndom duke e uruar njëri-tjetrit për festën e madhe, me shpresë që nëntorin ardhëm ta prisnim në Kosovën e çliruar nga Serbia.

U ulëm, dhe, para se u takuam me disa nga shokët tanë të tjerë, aty, me Hyzriun kemi biseduar për ndonjë dyzet minuta apo edhe më shumë për shumëçka, ngase ai ishte një erudit i vërtetë. Biseduam për ngjarje, për njerëzit që i njihnim, pak për histori dhe kështu me radhë. Ndër të tjerat Hyzriu më tha se i kishte pëlqyer, tej mase, një editorial, i një nate

më parë, i Enver Malokut i botuar tek ballina e gazetës së mbrëmjes “Informatori”, që kishte filluar të botonte, po ai, në Prishtinë. Dakordova me Hyzriun, ngase atë editorial të mikut tim e kisha lexuar edhe unë dhe më kishte lënë përshtypje të veçanta. Pastaj, së bashku me Hakiun u ngritëm, sërish u përfytëm me luftëtarin e shquar të UÇK-së, dhe me luftëtarë të tjerë, dhe u nisëm rrugës për në Bajgorë, por duke mos e pandehur dot se ky do të na mbetej kujtimi i fundit për dëshmorin e lirisë, Hyzri Tallën.

Në rrugë për në Shalë, ndaluan edhe në Bradash, prej nga kalonim në Dobratin e së andejmi në Kaçanoll. Ndaluan që ta takonim një mik tonin, tjetër, Nuredin Ibishin, të cilin nuk e kisha takuar që nga messhtatori i atij viti, në Majac. Atë, shumica e njihnim me emrin luftarak si, Komandant Leka, emër të cilin ia kishte vënë vetës.

Nura u gëzua shumë kur na pa, u përshëndetëm me të dhe me oficerin e lartë të UÇK-së, Arif Muçollin (Komandant Profën) dhe u uruam ndërmjet veti për festën tonë. E pimë nga një kafe dhe, pas ndonjë gjysmë ore e vazhduam rrugën për në Bajgorë, ku, në shkollën e fshatit po shënohej festa.

Diçka ka ndodhur në Prishtinë

Katër ditë pas këtij takimi me



Latif Gashi dhe Hyzri Talla

Hyzriun, në Prishtinë më cingëroi telefoni.

“Si je”, më pyeti. “A je në Prishtinë?”

Iu gjeja pozitivisht.

“Mirë, atëherë i thuj ‘Malësori’ që sonte të niset, urgjent, për në zonë”.

Ishte zëri i Komandantit Latif Gashit, mikut dhe të afërmit tim. “Është aq urgjente puna!?”, e pyeta.

“Po, po, diç ka ndodhur në Prishtinë dhe ‘Malësori’ duhet të tërhiqet në Zonë, pa alternativë”, më tha miku im me një zë disi të përhumbur.

“Malësori” ishte pseudonimi i Lirak Çelajt i cili kishte javë që ishte inkuadruar në radhët e UÇK-së dhe, sa herë që vinte në Prishtinë, lidhja me te, për shkak të sigurisë, mbahej përmes meje.

Bëra shumë përpjekje asaj nate që ta kontaktoja Lirakun. Ndërsa ai nga “Ulpiana” (ndërtesa D/9 ku po banonte ngase shtëpinë ia kishin, në Velani, po ia survejonin agentët të UDB-së), pasi që ramë në kontakt, erdhi në Dardani, ku isha tek banesa e nënës sime, dhe me makinë e tij, më shoqëroi deri në “Kodrën e Diellit” ku banoja. Me sugjerimin e tij, i ramë një rrugë shumë më të gjatë qarkore ngase, siç më tha Liraku, te “Imixhi” kishte ndodhur diçka dhe se, mbrapa konvikteve të studentëve kishte shumë policë. Përveç meje dhe Lirakut, në kerr ishte edhe Shpresa me Getoarben dhe Albburonin, shumë të vegjël. Kur shkuam tek banesa ime, unë i tregova Lirakut se më kishte marrë me telefon Lata dhe se ai, po asaj nate duhej të shkonte në shtab, në Llapashticë.

“Ka ndonjë paralajmërim”, më pyeti Liraku.

“Nuk e di”, ia ktheva. “Është

çështje sigurie, ngase, shërbimi i UÇK-së kishte paralajmërim se mund të ndodhte një fushatë e gjerë serbe në kryeqytet.”

“Po ti”, më pyeti Liraku.

“Unë kam punë këtu, dhe do të shihemi shumë shpejt ‘te vendi’”, ia ktheva me të qeshura.

Asaj nate unë po mendoja që të shkoja te një mik imi (Rahman Dini i LKÇK-së) për të kaluar natën, ngase ashtu do të isha më i sigurt. Siç e mora vesh më pas, Liraku, me babain e tij, të cilin, që kur kam filluar të merrem me gazetari e quaja Baca Zenun shkoi drejtë e në Llapashticë, në shtab. Ndërsa unë, kur, tashmë isha bërë gati që të shkoja tek te Rahman Dini të cilin e quanin “Bali”, më ra, sërish, telefoni mobil. Ishte numri shtabit të ZOLL.

“Alo!?”

“Liraku jam.”

“Do të thotë se paske udhëtuar mirë”, e pyeta.

“Po”, më tha, “por e kam një lajm të keq.”

“Më thuj, të lutem”, i thash me shqetësim.

“Hyzriu ka rënë në Prishtinë.”

“Hyzriu?”

“Po, Hyzriu”, ma ktheu Liraku.

Pastaj të dy heshtëm për një kohë dhe nuk e mbaj mend se a e këmbjem ndonjë fjalë ndërmjet veti.

Menjëherë mendja më shkoi tek ajo që kishte ndodhur mbrapa m qendrës së studentëve. Vërtetë u mërzita shumë.

Pasi u përshëndeta me Lirakun, i rashë unë numrit të mobilist dhe e thirra Latën.

“Hë, Latë, e vërtetë qenka kjo për Hyzriun, apo jo?”

“Lere, shoq”, më tha. “Shkoi

Hyzriu. Dhembje më të madhe nuk kam pasur kurrë!”

Lata më tregoi se ishte me dy shokë. Një zot e di pse, përnjëherë më shkoi mendja tek Afrim Maliqi. Ndoshta nga shkak se, në Majac, Hyzriu më kishte thënë që Afrimin e kishte prej shokëve më të mirë në jetë.

Afrimi ishte gazetar i “Rilindjes” në atë kohë. Kiamet.

Pasi që e ngushëlluam njëri-tjetri, Lata më tregoi se varrimi bëhet në pasdrekën e ditës së nesërme, më vonë.

Normal, Hyzriun, kishin vendosur ta varrosnin në Letanc, në varrezat e familjes. Unë dhe Hakiu, fillimisht shkua në Llapashticë, e më pas, rrugëve dytësore arritëm në Letanc. Ishin mbledhur goxha shumë njerëz.

Letanci është më shumë paralagje e Podujevës se sa një fshat i veçuar. Ndaj, komandantët e shtabit të ZOLL, kishin vendosur që ta krijojnë një pikë mbrojtëse, me më shumë ushtarë, andej nga drejtimi i qytetit të Podujevës, disa qindra metra larg nesh, që, në rast nevojë të na mbronin.

Shumicën e njerëzve që kishin ardhur, edhe nga Prishtina, përveç katër a pesë syresh, i nj. Aty kishin ardhur edhe disa gazetarë, por, ceremoninë e varrimit, ishte marrë vendimi, që ta xhironte Liraku i cili e kishte të veshur një jelek kamuflazh dhe e posedonte një kamerë shumë të mirë për atë kohë të cilën e kishte blerë shtabi. Por, kishte njerëz në varrim, që, faktin se Liraku i ishte bashkëngjitur radhëve të UÇK-së e morën vesh asaj mbrëmjeje. Njëri prej djemve të ilegales së UÇK-së, shkoi dhe i tha një gazetarit që po fotografonte që, në asnjë mënyrë, mos ta nxirrte emrin apo foton e Lirakut, ngase

ky mund të vinte në Prishtinë përsëri dhe se do të rrezikohej.

Ai bëri bëmë me nanë e babë se nuk do të gabojë në asnjë mënyrë dhe se nuk do ta nxjerr emrin e tij në asnjë mënyrë. Nata ishte e zymtë me qiellin gri. Zymtësia na kishte gëlltitur që të gjithëve. Një dhembje që nuk mund të përshkruhet dot.

Valon Murati: “Përveç një të ftohti të egër, asgjë nuk thoshte se kishim të bënim me një ditë ters”

“Tërë jetën nuk do të harrohet ajo natë”, më tha me një rast, bashkëlufëtari i Hyzriut, Valon Murati. “Tërë jetën nuk do të harrohen dyshimet e asaj nate, shpresat e asaj nate, hidhërimi, dhembja dhe mllëfi i asaj nate. Tërë jetën nuk do të harrohen lotët e asaj nate.

Nuk do të harrohet vaji i Llapashticës. Lotët e saj. Tërë jetën ajo natë do të sillet si një makth që do të na rrëmbejë për fyti dhe do të na thotë: “Hej, Hyzriun me shokë e vranë në pritë hej, Hyzriun!”



Një foto për gjithë jetën, në shtabin e Zonës Operative të Llapit Nga e majta (poshtë): Hyzri Talla, Sabedin Zejnullahu (Uka), Rrustem Mustafa (Remi), Latif Gashi (Fati), Muhamet Latifi, Në këmbë, nga e majta: Shefki Sejdiu dhe Sami Shatrolli

Valoni më tregoi se, asaj pasditeje kur u vra Hyzriu, nga kryeqyteti në Llapashticë kishin shkuar Cali me Cufën, një luftëtar tjetër të UÇK-së. Ata dy, vendosin që, atë natë, ta kalojnë në Llapashticë dhe pikërisht në shtëpinë ku rrinin Agim Kuleta, Valoni, e të tjerë luftëtar, në objektin ku përgatitej edhe revista “Çlirimi”, organ i LKÇK-së. Por, asgjë asaj nate nuk jepte ndonjë lloj paralajmërimi se diçka e tmerrshme mund të ndodhte.

“Përveç një të ftohti të egër, asgjë nuk thoshte se kishim të bënim me një ditë ters. Me shokët bisedonim për organizimin në qytet dhe për nevojën e masivizimit të këtij organizimi dhe të ngritjes cilësore të tij. Cali shkoi për në komandë për ta bërë një telefonatë. Kur kthehet, disponimi i tij kishte tretur i tëri. “Dikë e kanë vranë në Prishtinë”, na tha ai.

Ishin këto fjalë që i shtangin të gjithë në vend dhe që ua varrosën disponimin e mirë të e ushtarëve të UÇK-së, asaj nate. Pyetja kryesore që parashtrohej ishte se: kush mund të ishte i vrari, apo të vrrarit? Sa ishin? Si shin vranë? Ku? Ku? Ku?...

“Informacionet për ngjarjen ishin tepër të pakta, për të mundur të konkludonim çfarëdoqoftë”, thotë Valoni.

Gjithçka që dihej ishte se bëhej fjalë për një “Reno 5” me ngjyrë të kuqe. Guerilja jonë në Prishtinë e kishte një të tillë mirëpo, disi, ishin të bindur se ishte e pamundshme të ketë qenë kushdoqoftë nga guerilet, urbane, e UÇK-së, në kryeqytet, ngase informacionet ishin tejet të sakta se kush dhe nga kishte shkuar asaj nate me një makinë të tipit dhe të ngjyrës së tillë. Nga ana tjetër, as lajmi i pakonfirmuar për atë se ku kishte ngjarë krimi nuk perkonte me rajonin ku kishin shkuar djemtë e gueriles. Kush mund të ketë qenë? Ishte kjo pyetja e cila dalëngadalë nisi t’i torturojë pa masë njerëzit e shtabit.

“Vetëm të mos jenë shokë të organizimit, mendonim”, thotë Valoni. “Më vonë shkuam në komandën e zonës. Atje tashmë kishin nisur disa pëshpërime.”

Dhe, si nga një botë tjetër, dëgjohej fjala se ishte mundësia që, në atë makinë të sulmuar nga

serbët, mund të ketë qëlluar edhe Hyzriu.

“Si nuk na kishte shkuar mendja menjëherë, mendova”, thotë Valoni. “Mirëpo, kjo gjë është e pamundshme, thashë si në vete” thotë ai. “Ata Hyzriun nuk mund ta vrasin, doja të besoja ashtu.”

Pas mesnate, gjithçka nisi të qartësohej. Hyzri Talla më nuk ishte në mesin e të gjallëve. Apo, thënë më drejtë, asaj nate, ai, kaloi në përjetësinë e tij, bashkë me shokët e tij, Afrimin dhe Ilirin.

“Kur e sollën kufomën e tij, kur ia pashë trupin për së vdekuri, dhe ia pashë ato, njëzet e shtatë apo tetë plagë plumbash që ia kishin marrë trupin”, tregon Valoni, “e kuptova vërteta se ai tash më nuk ishte në mesin tonë. Por unë, kurrë, nuk u mësova me vdekjen e tij. Kurrë nuk u mësova me mungesën e tij. Me vdekje të tilla njeriu nuk mund të mësohet asnjëherë.”, përfundon Valon Murati, bashkëluftëtar i Hyzri Tallës.

Fatkeqësisht, kur u vra Hyzriu dhe më pas kur u bë varrimi i tij, Komandant Remi mungonte. Ai ndodhej në Dragobil në një takim në Shtabin e Përgjithshëm. Menjëherë pasi që dëgjoji për rastin e vrasjes së Hyzriut, ai e këputi vizitën e tij atje, mirëpo, përkundër kësaj, nuk arriti me kohë në varrimin e shokut dhe bashkëluftëtarit. Çfarë coincidence!

Latif Gashi: “Shkurt: Hyzri Talla ishte një prej shtyllave kryesore të UÇK-së në Llap”

“Kur të flasim për Hyzri Tallën”, më thotë miku dhe bashkëluftëtar i tij më i ngushtë, Latif Gashi, “mendoj se po kështu duhet të flitet për një fytyrë të shquar të historisë sonë më të re kombëtare, dhe për një nga figurat e ndritshme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, veçanërisht në Zonën Operative të Llapit.”

Ai thotë se Hyzriu ishte luftëtar i madh që iu përgjigj thirrjes së Atdheut dhe u bë pjesëtar i ushtrisë së tij. Ai, që nga inkuadrimi në radhët e UÇK-së, ka kryer detyra me rëndësi të veçanta, ndërsa vdekja e gjeti në detyrën e zëvendëskomandantit të Shërbimit Informativ të UÇK-së në Zonën Operative të Llapit.

“Dhe, më shkurt, mund ta them se Hyzri Talla ishte një prej shtyllave kryesore të UÇK-së në Llap, e sidomos në Shërbimin Informativ, kështu që, përveç dhembjes që na shkaktoi vdekja e tij, për familjen, për neve, shokët dhe bashkëluftëtarët, praktikisht mungesa e tij ishte diç e pakompensueshme”, thotë L. Gashi.

Latif Gashi tregon se me Hyzri Tallën kishte luftuar edhe në ilegalitet.

“Hyzriu ka qenë anëtar i shumë organizatave ilegale”, thotë Komandant Lata. “Ai ishte shumë serioz dhe trim i madh, por edhe shtylla më e fuqishme e ZOLL-it. Hyzriu, përpos betejave kur ishte

në krye të shokëve, mori pjesë edhe në disa aksione speciale kundër diversantëve serbë që tentonin të futeshin në zonën tonë, në prapavijë.”, tregon Latif Gashi.

Ishin ato aksione jashtëzakonisht të suksesshme. Hyzriu e përdorte, thuaja se gjithmonë, një armë moderne që e kishin në ZOLL e të cilën e quanin 84- she.

“Aksioni në të cilin futej Hyzriu”, thotë Lata, “armikut i shkaktonte humbje të mëdha. Më kujtohet një detaj kur zonën tone e vizituan Adem Demaçi dhe Shon Bërnsi. Unë dhe Hyzriu morëm përsipër sigurimin e tyre deri në magjistrale dhe për disa çaste e bllokuam magjistralen, duke i ndaluar shumë automjete që vinin nga Serbia. Ishte befasi për serbët kur ne dolëm në magjistrale me uniforma, sepse automjetet që i ndalëm ishin përplot me serbë, ndërsa kishte edhe të uniformuar. Ky ishte një mesazh për serbët që të mos hynin më në Kosovë”, rrëfen L. Gashi.

“Që nga fillimi i vitit 1997”, më thotë, Komandant Remi, një prej figurave të shquara të luftës sonë, “Hyzriu ishte ndërmjetësuesi kryesor i bashkimit të UÇK-së dhe të LKÇK-së. Madje, me meritën e tij u arrit marrëveshja me tre rreshta, me çfarë edhe filluam veprimin e përbashkët ushtarak.” Kjo marrëveshja parashihte që Fatmir Humolli dhe Hyzri Talla të ishin anëtarë të shtabit të UÇK-së të ZOLL-it dhe të punonin në masivizimin e ushtrisë. Detyrat e para që i jepën Hyzriut ishin të një rëndësie dhe të një rreziku shumë të madh. Ai merr përsipër që të bisedojë me një numër ushtarakësh të shkolluar që t’i inkuadrojë në radhët e UÇK-së.

Detyra e parë e tij ishte që ta kontaktojë Nuredin Ibishin-Lekën, me të cilin kishte pasur takime intensive gjashtë muaj para daljes publike të UÇK-së. Me aftësitë e tij dhe me sensin bindës merret vesh me Lekën që ai t’i bashkëngjitet ushtrisë. Më pas ka biseduar edhe me shumë eprorë të tjerë, me ç’rast me disa kishte suksese e me disa të tjerë jo. Hyzriu, pa u frikësuar fare, lëvizte në Prishtinë, edhe pse kishte detyra të veçanta dhe me rrezik. Rasti më i rrezikshëm ishte ai kur i shkoi inspektorit të sigurimit serb, Osman Veliqit në banesë dhe i thotë:

”Pse qëndron jashtë kur duhesh të përfshihesh në UÇK. Unë jam ai që të vë në lidhje me UÇK-në!”.

Hyzriu ishte aktiv në betejën e Bardhit të Madh, duke vepruar, atje, me Fatmir Humollin. Ai njëherë kishte mbetur vetëm i rrethuar nga forcat armike, por, falë aftësive që kishte, diti dhe mundi të dalë nga atje.

“Në betejën e Qafës së Kaçanollit, bashkërisht kemi dalë herët në mëngjes në pozitat tona. Kemi vendosur që unë me njësitin special të dalim në fshatin Dobratin, para pozicioneve të armikut, me qëllim që ta ngadalësonim pozicionimin e

armikut”, kujton Komandant Remi.

Hyzriu e bënë evakuimin e popullatës, por, fatkeqësisht, ai me atë rast u plagoset bashkë me një bashkëluftëtar tjetër me nofkën Luli. Por, edhe pse, vetë i plagosur, ai “Lulin” e bartë deri në Bajgorë, ku i jepet ndihma e pare dhe më pas kthehet në pozicione.

“Ndërsa, për ta ruajtur moralin e shokëve, Hyzriu, askujt nuk i kishte treguar se ishte i plagosur, ndërsa në mbrëmje na tregoi vetëm mua dhe Latës”, evokon Remi.

“Po e përmend edhe betejën e Llapashitës nga tetori i vitit 1998, kur automjetet e blinduar të armikut kanë provokuar pozicionet tona, me gjithë marrëveshjen me OSBE-në për mossulmim”, Tregon Komandant Remi. “Me atë rast Hyzriu me shokë hapi vijën frontale duke i thyer forcat armike.”

Hyzriun e dallonte një instinkt i veçantë i organizimit dhe i afrimit me popullatën.

“Më duhet ta them se Hyzriu ishte

njëri prej ushtarakëve më të mençur dhe më vizionar në Zonën Operative të Llapit”, thotë Remi.

Remi më thotë se Hyzriu dinte të jepte këshilla jo vetëm atij, por edhe eprorëve të tjerë. “Hyzriu për mua mbeti i pazëvendësueshëm”, përfundon Rustem Mustafa – Komandant Remi evokimin e tij për shokun e pushkës dhe të idealit. Ngjarja në “Lagjen e Muhaxhirëve” në Prishtinë dhe vrasja e Agron Rrahmanit Bahriu Fazliu (Gëzimit) u vra në kufi. Fatmir Humolli dhe Agron Rrahmani, gjendeshin në një bazë në Prishtinë. Lajmin për vrasjen e një personi në kufi këta e morën përmes mjeteve të informimit. Sipas urdhëresave që kishte nga LKÇK-ja, Bahriu nuk është dashur të gjendet atje në atë kohë. Ai kishte të shkonte në Dukagjin, që t’i kontaktojë njerëzit e organizatës, atje, pra, brenda vetë territorit të luftës, por jo edhe që të kalonte në Shqipëri.

Mediet e transmetuan lajmin se fjala ishte për një grup të

shqiptarëve të armatosur që kishin sprovuar të futeshin nga Shqipëria në Kosovë dhe me atë rast janë përleshur me forcat ushtarake jugosllave me ç’rast është vrasur një person.

“Ne njëherë as që kishim dyshuar se fjala mund të ishte për njërin prej liderëve të LKÇK-së, Bahri Fazliun”, thotë Fatmir Humolli. “Në atë kohë ne, përkohësisht, kaluam në Qyqavicë që ta takonim Sabit Gashin. Me ne atje erdhi edhe Avdi Kiçmari-Çeli”, thotë Fatmiri.

Pas pak ditësh, nga baza, këta luftëtarë, vendosin, që të shkonin në banesën e tyre në Lagjen e Muhaxhirëve të Prishtinës. Ndërsa, kur arrijnë në banesë, për befasinë e tyre, njerëzit e sigurimit serb ishin futur, tashmë, brenda dhe po i prisnin të ktheheshin.

“Agroni ka ecur para menje, ndërsa, si rëndom, unë jam ndaluar të shikoja pas se mos ishte kush duke na përcjell”, rrëfen Fatmir Humolli. “Agroni e ka pasur automatikun në dorë. Unë kam dëgjuar diçka, por njëherë më



Hyzri Talla

është dukur se ai po e hiqte fishekun nga tyta e armës. Por, në çastin, kur Agroni i është afruar derës, serbët kanë shtënë nga brenda. Unë këtë e kam kuptuar kur e kam parë Agronin duke dalë jashtë. Atë e kishin marrë plumbat. Mbi të ishte shtënë me armë me shurdhues të zërit. Kur e kam parë se është tërhequr pas Agroni, unë kam nisë të shtie drejt në shkijet dhe kam shkuar drejt Agronit të plagosur. Më janë shpenzuar të gjithë fishekët. E kam vënë re personin i cili shtinte mbi ne. Ai shtinte përmendësh dhe në panik. Dhe në atë çast plumbat e tij ma kanë marrë dorën mbi bërryl dhe ma kanë thyer atë. Unë e kam marrë revolen e Agronit në tytën e së cilës ka qenë fisheku. Për fat të mirë ai fishek ka shkrepur ngase, ka ekzistuar rreziku që të më kapin gjallë. Atëherë ata janë futur, përsëri, brenda”, kujton Fatmiri të cilin në luftë e thërrisnim Komandant Baci.

Në këtë çast, Fatmiri e ka nxjerrë bombën. Me dorën e shëndoshë ia ka nxjerrë siguresën. Me mjaft vështirësi, ngase i duhej mbajtur dorën e plagosur dhe atë bombë e ka hedhur mu në dhomën ku ishin policët e policisë sekrete serbe.

“Janë dëgjuar britma të shkijeve. Brenda është shkaktuar një pështjellim i madh. Gjatë asaj kohe unë e kam shfrytëzuar rastin që ta marrë Agronin dhe kam dalë nga oborri”, rrëfen Fatmir Humolli. “Kur kemi dalë jashtë, dikush prej tyre, ka shtënë edhe njëherë mbi ne. Pastaj jemi ndalur, për disa çaste në një udhëkryq dhe kam vëzhguar mos janë kund edhe serbët tjerë. Kur e kam parë se nuk ka të tjerë, atëherë ashtu e kam nxjerrë Agronin dhe e kam dërguar tek një shtëpi. Ai ishte ende gjallë. Kur e lashtë për të shkuar që t’i gjeja shokët për të na ndihmuar, Agroni ishte i pa ndjenja. I pa ndjenja, por i gjallë. Unë mendoja që të shkoja ta merrja Hyzri Tallën dhe me te të kthehesha ta merrja shokun tonë”, tregon Fatmiri.

Ky e dinte se Hyzriu, në këtë kohë, faktikisht gjendej në një banesë në Bregun e Diellit. Fatmiri arrin, disi, tek Hyzriu dhe atij i tregon, fije për

pe për atë që kishte ndodhur, dhe, që të dy, menjëherë janë nisur për ta marrë Agron Rrahmanin të cilin, Fatmiri e kishte lënë të plagosur. Por ai, tashmë, kishte ndërruar jetë.

“Hyzriu e ka pasur një ‘kallash’ me vete. Kur i patëm sjellë, bashkë me Agronin, armët nga Shqipëria, i pat ndalur katër bomba dhe një ‘kallash’, më rrëfen F. Humolli. Meqë Lagjja e Muhaxhirëve ishte e rrethuar, ndërsa Fatmiri bukur rëndë i plagosur, atëherë Hyzriu, ashtu duke ecur këmbë nëpër qytet, më ka dërguar deri në Taslixhe, ku ndihmën e parë ma kanë dhënë mjekët e SHB “Nëna Terezë”, në krye me doktor Gani Demollin.

“Edhe shërimin ma kanë bërë këta mjek në ambulancën në Kodrën e Trimave, prej nga kam kaluar në një bazë tonën tjetër, ilegale”, më thotë miku im, F. Humolli.

Hyzriu, në ilegalitet ka kaluar pas kësaj kohe, pasi që e kishte vënë re se po i vëzhgohej shtëpia nga UDB-ja.

“Hyzriu ka qenë një burrë vërtetë syapatrembur dhe deri në çastin e fundit nuk është tërhequr në ilegalitet të plotë”, tregon Fatmiri.

“Por, edhe deri atëherë, ai, gjithnjë, ka qenë me armë pranë vetes dhe shumë i kujdesshëm. Do të thotë ishte gjithmonë i gatshëm për t’u kundërvënë” tregon eprori i lartë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Fatmir Humolli.

Kur kalon Hyzriu në ilegalitet, atëherë, pasi që u nënshkrua edhe marrëveshja ndërmjet LKÇK-së dhe UÇK-së, që të dy këta, kalojnë në Qyqavicë, e mëpastaj rikthehen në Llap.

Atentatorët e Hyzri Tallës me shok pjesëtarët e Njësisë Speciale “SAJ” që komandoheshin nga, Vllado Todoroviq dhe Zharko Matunoviq Të dhënat që i kam mbledhur gjithandej mbi vrasjen e Hyzri Tallës me shokë, fillimisht, nuk ishin të shumta. Dihej, pra, që, vrasja ndodhi më 2 dhjetor të vitit 1998, në orën 16 e 45 minuta në “Bregun e Diellit” kur është shtënë, nga të gjitha anët mbi një “Renault” 19 Chamade me targa të Prishtinës PR 200-227. Por, më pas e kemi kuptuar se, urdhërues



Valon Murati

për atë vrasje ishte, Mishko Llakoviq, një prej shefave kryesor të sigurimit serb në Kosovë. Ekzekutuesit ishin pjesëtarët e Njësisë Speciale “SAJ” që e kishin selinë në Hajvali, me komandantin e tyre, Vllado Todoroviq, ndihmës komandantin Zharko Matunoviq, dhe pjesëtarët tjerë të njësisë speciale që, asaj nate kishin lëvizur me automjetet për ekzekutim, “BMW”, një “Audi 80” si dhe dy kombi civilë.

Snajperistët kanë qenë të vendosur në banesën e Bogdan Kecmanit, një paramilitar serb i ekspozuar nga koha e Millosheviqit dhe udhëheqës i organizatës paramilitare, “Bozhur”. Ndërsa, në afërsi të vendit të krimit, në përcjellje, ka qenë Sllavisha Filliqi me pjesëtarët tjerë të Sigurimit Shtetëror Serb që vepronin në Kosovë. Kështu, kjo vrasje e Hyzri Tallës, Afrim Maliqit dhe e Ilir Durmishit, u bë në mënyrë tejet profesionale ngase sigurimi serb kishte marrë masa që të mos dështonin në asnjë mënyrë. Por, për fat të keq, të dhëna flasin se në ndihmë forcave serbe u kishin ardhur edhe disa shqipfolës që ishin bashkëpunëtor të Serbisë kundër shqiptarëve.

Atentati mbi udbashin, Mishko Llakoviq

Mirëpo, kjo histori nuk përfundoi këtu. Vetëm ndonjë dhjetë ditë pas vrasjes së Hyzriut, një njësit i guerilës urbane në Prishtinë, e mori detyrën që ta nxjerrë hakun e Hyzriut me shokë dhe për të qëlluar mbi ndonjë personalitet të lartë të UDB-së në kryeqytet. Në fakt, kishte goxha kohë që, guerilja jonë, e kishte lokalizuar shtëpia e kriminelit, Mishko Llakoviqit dhe, me këtë rast, ia vunë pritën, mu tek udhëkryqi, matanë, gjimnazit “Sami Frashri”. Ishin disa djem dhe vajza në aksion. Këta e kishin përcjellë lëvizjen Llakoviqit për më shumë ditë dhe e dinin kohën kur, ai, afërsisht, kthehej në shtëpi dhe çfarë kerri kishte. Normal,

kerri ishte zyrtar por me targa private dhe asnjë shenj policie. Dhe, për fat, që në natën e parë kur u vu prita, guerilasve të Prishtinës nuk iu desh që të prisnin shumë e ta vënin re makinën e Llakoviqit e cila po afrohej drejt tyre. Dhe, kur u afrua fare pranë tyre, ata kanë qëlluar me breshëri, nga gjashtë armët, në



Hyzri Talla dhe Fatmir Humolli me shokë

një zë. Makina e udbashit famëkeq, ndalon diku në katër apo pesë metra vendit ku u qëllua dhe deri ku e barti inercioni. Në makinë nuk lëvizte askush. Guerilët e UÇK-së tu tërhoqën shpejt, ngase vendi ishte shumë i zbuluar dhe pritëshin që, aty, të arrinin forca të mëdha serbe që erdhën menjëherë. Kur, diku nga dymbëdhjetë dhjetori shkova, sërish, në Llapashticë, dikush prej shokëve më pyeti se mos kisha dëgjuar gjë për Mishko Llakoviqin, dhe se, mos ishte vrarë m..i. Për të qenë i sinqertë unë vërtetë nuk kisha dëgjuar asgjë, ngase mediet serbe, për arsye të tyre nuk kishin publikuar asgjë.

Kur u ktheva, të nesërmen, nga Llapashtica në Prishtinë, njeriun e parë që e takova në kryeqytet ishte, miku im i fëmijërisë, Agim Musliu. U ula dhe bisedova me të gjerë e gjatë për çështjen e atentatit tek rruga e gjimnazit, si

dhe për Mishko Llakoviqin. Edhe Agimi, që ishte një ekspert (par excellence) i luftës më tha se UÇK-ja e kishte sulmuar dikë të “madh” të policisë serbe dhe se, me atë rast ishin plagosur rëndë dy policë, ndërsa njëri kishte shpëtuar lehtë. Që të dyve mendja na shkoi tek Llakoviqi.

Dhe, ashtu, ditë pas ditësh, duke vjelë një informatë “këtu” e një “atje”, me Agimin e krijuam mozaikun e saktë: asaj nate, në kerrin e Mishko Llakoviqit ishin plagosur shumë rëndë Sllavisha Filliqin i UDB-së si dhe i biri i Llakoviqit, që, gjithashtu, ishte paramilitarë. Llakoviqi kishte shpëtuar paq.

Pas kësaj, S. Filliqin dhe të birin e Mishko Llakoviqit i dërgojnë, për shërim, në Beograd. Filliqi, më, nuk është kthyer në luftë në Kosovë, edhe pse u mbijeton plagëve të rënda por ishte fizikisht i paafët. Ndërsa djali i kriminelit shpëtoi më lehtë.

Është interesante e kaluara e Mishko Llakoviqi, para se të punësohej në UDB. Ai, në fund të gjashtëdhjetave dhe në fillim të shtatëdhjetave, ishte futbollist, dhe i vetmi sllav që ka luajtur futboll tek ekipi i njohur prishtinas, “Flamurtari”.

Flamurtari ishte klub futbollistik që ishte krijuar në vigjilje të lejimit të flamurit kombëtar për shqiptarët dhe ne e donim së tepërmi, mu për këtë.

Ndërsa S. Filliq, viteve të tetëdhjeta ka luajtur hendboll për Prishtinën. Madje kemi luajtur bashkë në këtë ekip. Ai shquhej për një inteligjencë të ulët dhe për ngathtësinë e tij fizike... Një ditë u egërsua, serbisht.

Të dhënat që tregojnë janë edhe ato se, pikërisht Sllavisha Filliqi e kishte udhëhequr njësitin i cili i vrau në pritë, në Pestovë, Zahir Pajazitin, Hakif Zejnullahun dhe Edmond Hoxhën. Një e veçantë e tij ishte se shqipen e ka njohur shumë mirë, ngase, shtëpinë e kishte, mbi hekurudhë, paksa pranë urës mbi atë rrugë treni, në Kodrën e Trimave, dhe ishte rritur me shqiptar.

#perjetesishtuck



Kadri Kastrati dhe Latif Gashi tek vendi ku është vrarë Hyzri Talla me shokë (nëntor 1999)

Nuk është një Botëror. Është një kauzë. Një rebelim!



Nga Sid LOWE

Lionel Messi ka lamtumirën që ka dëshiruar. Ose të paktën, ka të ngritur skenën. Të dielën do të luajë finalen e gjashtë të madhe me Argjentinën. Do të jetë ndeshja e tij e 26-të në Kupën e Botës, më shumë se kushdo tjetër, një tjetër rekord ky; do të jetë edhe ndeshja e tij e fundit. “Fakti që përfundoj udhëtimin tim në finale më bën të lumtur dhe gjithçka që kam jetuar këtu është shumë e bukur,” tha ai në fund të një tjetër nate, të zbukuruar nga një tjetër moment magjik, si një dhuratë: diçka për ta patur dhe mbajtur fort, kur ai të ketë ikur. Jemi edhe katër ditë larg nga ajo ditë.

Katër ditë. Një natë. Të gjithë “e dinin” se kjo do të ishte Kupa e fundite Botës për Messin, teksa ndjenja se mund të mos e shohim më kurrë, ka qenë e pranishme në çdo ndeshje. Ai e dinte edhe këtë, dhe është pjesë e arsyes pse ka luajtur kështu: quhet mision, fat ose, thjesht kënaqësi. Rroke ditën, nuk kanë mbetur shumë të tilla. E megjithatë, 16 vjet pas ndeshjes së tij të parë, si shënues në atë fitore 6-0 kundër Serbisë dhe Malit të Zi, ta dëgjosh të konfirmohet nga ai vetë, sërish dhemb. Prit, çfarë? Finalja do të jetë ndeshja e fundit? “Po, me siguri do të jetë”, tha Messi të martën mbrëma, “janë shumë vite deri në Botërorin e ardhshëm dhe nuk mendoj se do t’ia dal. Ta përfundoj në këtë mënyrë është bukur.”

Pra, kjo është një lamtumirë, për sa i përket Argjentinës. Megjithatë, çfarë mënyre fantastike për t’u larguar. Nuk ka ndodhur ende:

pritet ndeshja më e madhe e të gjithave. Është kolosale, sigurisht. Por edhe duke arritur deri aty, duket sikur diçka ishte fituar, sikur ishte një realizim ishte përmbushur. Nga Messi dhe për Messin. Nuk e dimë se çfarë kemi derisa të ketë ikur (pothuajse). Vonë në Lusail, një gazetare e televizionit argjentinës, zgjodhi të mos e bënte pyetjen e saj të fundit. Në vend të kësaj, dhe ju mund ta keni parë klipin tashmë, ajo e përdori kohën për ta falënderuar: “Sido që të jetë rezultati, i ke bërë njerëzit të lumtur,” tha ajo. “Ke ndikuar në jetën e të gjithëve.”

Me kalimin e kohës, bëri edhe veten e tij të lumtur, me pak ndihëm edhe nga miqtë, të rinj dhe të vjetër. Në fund të Kupës së Amerikës, kur u mund nga Kili në finale, ai u largua. Nuk ishte ndërjetë gjithmonë i mbështetur, pesha ishte e papërballueshme; tha se kish filluar të ndiente sikur gjithçka ishte për fajin e tij. Siç deklaroi ai vetë atëherë: “Më është dashur të ha shumë mut”. Tani është ndryshe. “Ka kohë që po e shijoj shumë, çdo gjë që po ndodh me ne. Më bën të lumtur fakti që mundem t’i jap fund këtij rrugëtimi në finale”.

Kjo ka qenë doktrina e trajnerit, Lionel Scaloni: nesër dielli do të lindë sërish. Messi e ka përqaftuar atë mesazh dhe kohën që i ka mbetur; është bërë edhe mesazhi i tij, dhe ka pasur një ndjesi, sikur shokët e tij të skuadrës janë investuar jo vetëm për suksesin e Argjentinës, por edhe për lumturinë e tij, për të bërë një lloj drejtësie.

“Njerëzit e kanë kuptuar që kjo është diçka që ne duhet ta shijojmë”, tha Messi. “Kemi bërë

gjëra të jashtëzakonshme: Kupa e Amerikës, 36 ndeshjet pa u mundur, një finale e Kupës së Botës. Natyrisht, të gjithë duam ta fitojmë, por është një ndeshje futbollit dhe gjithçka mund të ndodhë. Shpresoj të jetë ndryshe nga ndeshja e Brazilit, në 2014 kundër Gjermanisë”.

“Nuk e di nëse kjo ka qenë Kupa më e mirë e botës për mua, por unë e kam shijuar që kur mbërritëm këtu”, shtoi ai. Ka realizuar 5 gola dhe ka dhënë 3 asiste. Momentet më të bukura këtu janë të tijat. Goli kundër Meksikës dhe goli kundër Australisë janë parë me mijëra herë. Asisti absurd kundër Kroacisë, një ikonografi e çastit: Josko Gvardiol, mbrojtësi për të cilin po flisnin të gjithë, u kthye e u stërkthye, pothuaj si në një film me kartona.

Messi udhëheq në Botëror me statistika në gola, asiste, shanse të krijuara, driblime dhe faulla të pësuar. Të cilat ende nuk e kanë ndaluar. Ai ka luajtur çdo minutë. Ai ka qenë Maradonian. Ka bërë Maradonën. Dhe jo vetëm prej shkëlqimit dhe energjisë, shprehjes së përkushtimit, identifikimit. Sakrificës. Messi kish mbajtur për një kohë të gjatë kofshën, pastaj i bëri atë që i bëri Gvardiolit. Ka të bëjë me refuzimin absolut për t’u dorëzuar: Ishte ai që deklaroi se nuk kishte marrë fund, pas humbjes me Arabinë Saudite. Ka të bëjë me lidërshtimin e njeriut që tërhoqi skuadrën. Mund të mos ketë moment që tregon aftësinë e tij të jashtëzakonshme si ai në gjysmëfinale, por kjo nuk krahasohet me shpërthimin pas golit kundër Meksikës.

Ishte shpërthimi i zemërimit që i

parapriu golit kundër Australisë. Përplasjet kundër Holandës. Tensioni, agresioni, fjalët e pista, po të doni. Ajo shprehja “pse shikon, budalla?”. Tifozëve argjentinës u pëlqen shumë. Duket se edhe Messi.

“Ai kështu ka qenë gjithmonë”, këmbëngul Scaloni, dhe brenda tij ka një lojtar shumë të fortë. Ky nuk është thjesht një Botëror. Është një kauzë. Një rebelim!

“Ndonjëherë është një situatë ekstreme, nuk është e lehtë të zbresësh në fushë duke ditur që duhet të fitosh, në të kundërt ikën në shtëpi. Ne na ka ndodhur kjo qysh prej ndeshjes së dytë. Ka patur një kosto mendore, dhe grupi e ka kapërcyer”, tha ai. “Kemi luajtur pesë finale dhe kemi edhe një”.

Do të ishte gabim të harrohej se si ai i ka tërhequr drejt finaleve edhe më parë, por sërish kjo është diçka tjetër. Ai duket ndryshe, tingëllon ndryshe, vepron ndryshe. Qoftë sepse bashkëudhëtar ka një tjetër brez, roli i tij ka ndryshuar, një pjesë e peshës së të kaluarës ka ikur, është lënë pas. Megjithatë, ka dhe një trashëgimi, thotë Scaloni, që Leo do ua lërë atyre. Ndërsa ata, kanë qenë të dëshpëruar për t’i dhuruar atij këtë vallëzim të fundit. “Ajo që bëri në Kupën e Amerikës ishte e pabesueshme, por unë në jetën time nuk kam parë asgjë si kjo Kupë Bote”, tha portieri Emiliano Martinez. Cristian Romero shtoi: “Është çmenduri. Të gjithë e dinë se çfarë është Messi si futbollist, por kjo ka të bëjë më shumë me llojin e njeriut që është. Ai është një shembull, një person që do gjithmonë më shumë. Ka marrë kaq shumë goditje, por gjithmonë

ringrihet në këmbë”.

Gjatë ditëve të fundit, një fotografi ka qarkulluar shumë në internet: në të, Julian Alvarez, 11 vjeçar qëndron në krah të idhullit të tij, Lionel Messi. Sot, ka një tjetër fotografi, pas 11 vjetësh: këtë herë janë shokë skuadre, Messi e mban në krahë dhe rrezaton pasi sulmuesi i Manchester City-t ka shënuar kundër Kroacisë.

“Gjërat që bën Leo janë të pabesueshme”, thotë Alvarez, dhe ai e ka parë me sytë e tij, ka qenë aty për t’i dhënë dorën e fundit një aksioni të pabesueshëm, një asisti që është më i bukuri i Botërorit. Mund të krahasohet vetëm me atë që Messi i dha Nahuel Molinës, në ndeshjen kundër Holandës.

Messi i ka dhënë të dy ata pasime. Ndërkohë, kish qenë Enzo Fernandez që kishte dhënë pasin e parë, i cili çoi drejt penaltisë që Messi e ktheu në gol. Edhe ai është rritur duke ndjekur njeriun që i dha Argjentinës avantazhin, që i mori dhe i çoi në një tjetër finale, ashtu si Diego Maradona.

Në vitin 2016, kur Messi po mendonte që të largohej, Fernandez postoi një mesazh në faqen e tij në Facebook, ku në fund kishte vendosur shënimin, na fal dhe faleminderit. “Si do arrijmë të të bindim ne, një grup askusësh që nuk kemi as 1 përqind të presionit që ti ke mbi shpatulla, 40 milion njerëz që bëjmë kërkesa qesharake për perfeksion, kur as nuk të njohim?”, thuhej në postim. “Bëj çfarë të duash, por të lutem mendo të qëndrosh dhe ta shijosh”.

Tani ai më në fund po e shijon, dhe ata po na çojnë të gjithëve drejt një lamtumirë finale. / *The Guardian* – Bota.al

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82

Kroacia dhe Maroku 'luftojnë' për vendin e tretë

"Epoka e re"

DOHA, 16 DHJETOR - Kroacia dhe Maroku përballen sot (e shtunë) në kuadër të Kupës së Botës për vendin e tretë. Në gjysmëfinale Kroacia pësoi humbje nga Argjentina me rezultat të thellë 3-0 dhe paraqitja e kroatëve ishte larg prej pritshmërive që u krijuan pasi e eliminuan Brazilin. Trajneri Zlatko Daliq, në konferencën për medie, një ditë para duelit me Marokun, ka thënë se skuadra e tij synon vendin e tretë në Kupën e Botës "Katar 2022". "Kemi disa lojtarë me probleme fizike. Gvardiol ka luajtur me dëmtim në këmbë, ka probleme edhe Brozoviqi. Për finalen e vendit të tretë-katërt do të rreshtoj vetëm lojtarë të gatshëm për të luajtur,

do të bëjmë gjithçka për të fituar. Ne duam të të përfundojmë të tretët. Do të bëjmë gjithçka për medaljen e bronzit dhe për një vend në podium", ka thënë Daliq. Ndërsa Maroku ishte befasia më e madhe e këtij kampionati për faktin se arriti të kualifikohet deri në gjysmëfinale ku pësoi humbje nga Franca (2-0), por paraqitja e futbollistëve marokenë ishte për çdo lëndatë. Trajneri i Marokut, Walid Regragui, ka thënë se synimi i tyre ishte të luajnë në finale, por tash e duan vendin e tretë. "Nuk është finalja që donim, por është një moment i madh për ne. Lohja është një faktor i rëndësishëm. Do të bëjmë gjithçka për të përfunduar në vendin e tretë. Mesazhi është se na ka mbetur edhe një ndeshje, djemtë e kanë kuptuar mirë që të

FORMACIONET E MUNDSHME:

Kroacia: Livaković; Juranović, Lovren, Sutalo, Sosa; Modrić, Jakić, Kovačić; Vlastić, Kramarić, Perišić

Maroku: Bono; Hakimi, El-Yamiq, Dari, Attiyat-Allah; Ounahi, Amrabat, Amallah; Ziyech, En-Nesyri, Boufal.

jesh i treti nuk është njësoj si të jesh i katërti. Nuk ka nevojë për motivim, ne luajmë për vendin tonë", ka thënë Regragui. Ndeshja në mes të Kroacisë dhe Marokut zhvillohet nga ora 16:00, kurse finalja në mes të Argjentinës dhe Francës zhvillohet të dielën nga ora 16:00.



Takime interesante në Superligën e basketbollit



PRISHTINË, 16 DHJETOR - Në fundjavë zhvillohet xhiroja e 14-të në Prince Caffè Superligë. Ndeshja e parë zhvillohet në mes të Ponte Prizrenit dhe Sigal Prishtinës, skuadra që u takuan edhe në çerekfinale të Superkupës, ku fituan prishtinasit. Prizrenasit kanë gjashtë fitore e gjashtë humbje, kurse kryeqytetasit kanë nëntë fitore e katër humbje. Takim shumë i vlefshëm shihet ndërmjet Rahovecit dhe Pejës. Rahovecasit numërojnë dy fitore e 11 humbje, ndërsa pejanët janë në vendin e parë me dhjetë fitore e tri humbje. Të dielën do të përballen Bashkimi me Golden Eagle Yllin. Prizrenasit kanë katër fitore e nëntë humbje, ndërsa therandasit

pas katër humbjeve në fillim, tani janë në një seri pozitive prej tetë fitoreve radhazi. Ndeshja e fundit e kësaj xhiroje zhvillohet ndërmjet Trepçës dhe Vëllaznimit. Të dyja skuadrat kanë nga gjashtë fitore e shtatë humbje, andaj pritet një duel shumë interesant të dielën në Mitrovicë.

SUPERLIGA - Java 14

Të shtunën takohen:
 17:00 Ponte Prizreni-Sigal Prishtina
 19:00 Rahoveci-Peja

Të dielën takohen:
 17:00 Bashkimi-Golden Eagle Ylli
 19:00 Trepça-Vëllaznimi

Dy derbi në hendboll

PRISHTINË, 16 DHJETOR - Dy ndeshje shumë interesante dhe të forta luhen të shtunë në kuadër të javës së 13-të të Superligës së Kosovës në hendboll. Nga ora 18:00 në Prishtinë takohen Prishtina dhe Besa Famgas. Pra, e para me të dytën në tabelë. Besa udhëheq me 19 pikë, ndërsa Prishtina është e dyta me 16 pikë. Kampionia aktuale, Besa, udhëton për fitore dhe për stabilizim në pozitën e parë, pasi lëshoi pikë në mesjavë, kur barazoi me Kastriotin. Ndërkohë

kryeqytetasit do ta japin më të mirën për fitore dhe për t'iu afruar Besës në tabelë. Prej orës 19:00 është derbi tjetër i xhiros në mes të Kastriotit dhe Trepçës. Kastrioti synon të vazhdojë me rezultate pozitive, pasi ndali Besën në barazim. Ndërkohë Trepça është në moment të mirë dhe synon të shënojë fitore të re. Të dielën është tjetër ndeshje interesante. Nga ora 18:00 takohen Rahoveci e Deçani. Java mbyllet të hënën prej orës 19:30, ku takohen Llapi e Vëllaznimi.



Vdes trajneri serb Sinisa Mihajloviq

ROMË, 16 DHJETOR - Ish-futbollisti serb Sinisa Mihajloviq ka vdekur në moshën 53-vjeçare. Ai vdiq në një klinikë të Romës këtë të premte. Ish-trajneri i Bolognas

po vuante nga sëmundja e rëndë për të cilën kishte njoftuar në vitin 2019. Lajmi për vdekjen e ish-futbollistit u bë i ditur nga familja. Mihajloviq, përveç

Bolognas, ka drejtuar edhe Sporting Lisbonën, Torinon, Milanin, Sampdorion, Fiorentinan, Catanian, si dhe ishte përzgjedhës te

Përfaqësuesja e Serbisë. Si futbollist, Mihajloviq karrierën e kaloi duke luajtur te Crvena Zvezda, Roma, Sampdoria, Lazio dhe Interi.



Mbappe 'ndez' finalen: Argjentina nuk e ka nivelin e Evropës

DOHA, 16 DHJETOR - Kylian Mbappe ka ndezur finalen përpara kohe. Sulmuesi francez është shprehur se sheh Francën favorite, pasi niveli i Evropës është më lart se ai i Amerikës së

Jugut. 23-vjeçari thotë se Argjentina dhe Brazili nuk kanë nivel gare në kualifikueset për në Botëror, prandaj fituesit e Kupës së Botës kanë qenë evropianë në kompeticionet e fundit.

“Avantazhi që kemi ne evropianët është se luajmë gjithmonë kundër njëritjetrit dhe kemi ndeshje të nivelit të lartë. Argjentina dhe Brazili nuk e kanë atë nivel gare në Amerikën e

Jugut. Futbollit atje nuk është aq i zhvilluar sa në Evropë dhe kjo është arsyeja përse fituesit e fundit të Kupës së Botës kanë qenë evropianë”, ka deklaruar Mbappe.



Kupa e Botës për klube zhvillohet në vitin 2025

DOHA, 16 DHJETOR - Botërori 2022 në Katar po përfundon dhe presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, mbajti konferencën përmbyllëse për shtyp të ngjarjes. Përveçse nënvizoi gjithçka që ndodhi gjatë kompeticionit ndërkombëtar, një nga më të vështirët nga të gjitha këndvështrimet, Infantino, ka shfrytëzuar rastin edhe për të paralajmëruar shumë gjëra të reja për të ardhmen. E para, ndoshta më novatore dhe më e papritura, është ajo që lidhet me një kompeticion të ri, Botërorin për klube, por jo siç e kuptojmë ne sot. Në të vërtetë, Infantino shpall miratimin përfundimtar për Kupën e Botës për klube, në të cilën do të marrin pjesë 32 skuadra. “Kupa e re e Botës për klube për meshkuj do të zhvillohet në vitin 2025 dhe do të ketë pjesëmarrjen e 32 skuadrave. Turneu me 32 ekipe do të vazhdojë, duke e bërë atë si një Kupë Bote”, ka thënë Infantino. Ky



turne do të luhet çdo katër vjet, se si do të strukturohet mbetet të mësohet. Natyrisht duhet të kuptojmë se ku do të luhet por, mbi të gjitha, kur dhe në cilën periudhë të vitit, duke pasur parasysh orarin tashmë të

ngjeshur. Është gjithashtu kurioze t'i dimë mënyrat e qasjes dhe, rrjedhimisht, të kualifikimit në Botërorin e ri të klubeve, të cilat, ndoshta, do ta kenë parasysh renditjen dhe sukseset e arritura në turnetë e ndryshëm kontinentalë.

Phoenixi ruan kreun, zhgënjejnë Milwaukee dhe Houstoni

Houston, 16 dhjetor - Skuadra e Memphisit triumfoi me rezultat 142-101 ndaj Milwaukee, në një ndeshje të dominuar nga vendasit. Antetokounmpo realizoi 19 pikë, por nuk arriti të ishte lider në këtë sfidë, ndërsa për Memphisin, tetë lojtarë realizuan mbi 10 pikë. Ja Morant realizoi një “triple double”, me 25 pikë, 10 rebounde e 10 asistime. Miami mposhti Houstonin (111-108) jashtë fushës, në një sfidë të ekuilibruar deri në fund. Tyler Herro me 41 pikë ishte shënuesi më i mirë në parket për Heat. Fitoi edhe Phoenixi, që mundi me shifrat 111-95 Clippersat, duke ruajtur kreun në Perëndim. Birdges me 27 pikë ishte më i miri



për Suns. Pas kohës shtesë fitoi Utah Jazzin, që mundi 132-129 ndaj New Orleansit, dy ekipe rivale në Perëndim. Clarkson me

39 pikë e Markkanen me 31 bën diferencën në parket për Jazz, duke i bërë të pavlefshme 31 pikët e Williamsonit për miqtë.

REZULTATET

Houston - Miami	108-111
Memphis - Milwaukee	142-101
Utah Jazz - New Orleans	132-129
Clippers - Phoenix	95-111

SHKURT

Deschamps zbulon se ka një plan për ta ndalur Messin

Trajneri Didier Deschamps ka lënë të kuptohet se Franca ka një plan për të ndalur Lionel Messin në finalen e Kupës së Botës kundër Argjentinës. Messi ka shënuar pesë gola dhe tri asistime për “Albiceleste” gjatë kësaj Kupe të Botës, por Franca është e gatshme t'i marrë “masat paraprake” të nevojshme që ta ndalin ndoshta lojtarin më të madh të të gjitha kohëve. “Ne e kemi takuar tashmë atë. A ju kujtohet në Kupën e Botës 2018? Ne do të mendojmë për të. Në mënyrë të pashmangshme, duhet të merren masa për ta kufizuar ndikimin e tij. Katër vjet më parë ne prisnim që ai të ishte më shumë në të djathtë dhe ai luante qendërsulmues. Tani ai është një organizator, ka më shumë liri, kështu që do të jetë më e vështirë ta markosh”, ka thënë Deschamps.

Busquets pensionohet nga kombëtarja

Sergio Busquets ka njoftuar tërheqjen e tij nga Kombëtarja e Spanjës pak ditë pas humbjes në çerekfinale të Kupës së Botës në Katar ndaj Marokut. “Dua të njoftoj se pas gati 15 vjetësh e 143 ndeshjesh, ka ardhur koha për t'i dhënë lamtumirën kombëtares. Dua t'i falënderoj të gjithë njerëzit që më kanë shoqëruar në këtë rrugë të gjatë. Nga Vicente del Bosque që më dha mundësinë për të filluar, te Luis Enrique që më bëri të lumtur deri në sekondën e fundit. Falënderoj, gjithashtu, Julen Lopetegui, Fernando Hierro dhe Robert Moreno për besimin e tyre, si dhe të gjithë stafin e tyre”, ka shkruar Busquets.

Szymon Marciniak gjykon finalen Francë - Argjentinë

Szymon Marciniak është gjyqtari që do ta gjykojë finalen në mes të Francës dhe Argjentinës. 41-vjeçari është zgjedhur nga FIFA për ta drejtuar ndeshjen më të rëndësishme të vitit, e planifikuar për t'u zhvilluar të dielën në orën 16:00. Marciniak ka arbitruar dy ndeshje në këtë Botëror: Francë - Danimarkë në fazën e grupeve (2-1) dhe Argjentinë - Australi në fazën e 1/8-ave (2-1).

Telashe për Golden State, lëndohet Curry

Telashe për skuadrën e Golden State Warriors, pasi kapiteni dhe lojtari i saj më i mirë, Stephen Curry, është lënduar në sfidën e fundit ndaj Indianas. Ky lëndim ndodhi në periodën e tretë, duke detyruar kampionin e NBA-së të lërë fushën e lojës para kohe. Curry pati një kontakt me Jalen Smith, ndërkohë që pas ndeshjes ka kryer menjëherë një rezonancë magnetike të shpatullës. Pas përfundimit të analizave, mjekët konfirmuan dëmtimin e shpatullës së djathtë, duke shtuar se lojtari do të qëndrojë disa javë pushim absolut. Për pasojë, ylli i NBA-së nuk do të luajë më këtë vit dhe do të rikthehet në fushë vetëm në mesin e janarit. Skuadra kampione e Golden State po kalon një moment jo fort të mirë, duke humbur mjaft ndeshje, sidomos jashtë fushe.

Maroku ankohet në FIFA: Na janë mohuar dy penallti ndaj Francës

Federata Marokene e Futbollit i ka dërguar një letër zyrtare FIFA-s duke kundërshtuar arbitrimin e meksikanit Cesar Arturo Ramos gjatë ndeshjes Marok-Francë. FRMF

denoncon faktin se skuadrës marokene i janë mohuar dy penallti, të pasinjalizuara nga gjyqtari i ndeshjes, apo nga mospërdorimi i sistemit VAR. Aksioni më i kontestuar i

ndeshjes është ai në minutën e 27-të kur gjyqtari i dha kartonin e verdhë Sofiane Boufal, i cili ndërkohë sapo kishte pësuar një ndërhyrje nga Theo Hernandez në zonën e

francezëve. Penalltia e dytë, të cilën duhet ta kishin marrë sipas tyre, ndodhi në fundin e pjesës së parë pas aksionit të Selim Amallah. Ai është rrëzuar brenda zonës pas një ndërhyrje

nga Tchouameni. FRMF garanton se “do të mbrojtë deri në fund interesat e kombëtares” dhe do t'i ndjekë “të gjitha rrugët e mundshme për t'u dhënë drejtësi Luanëve”.



ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

